

**BANKA OTP ALBANIA SH.A.**

**Raporti i audituesit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare në datën dhe për vitin  
e mbyllur më 31 Dhjetor 2023**

<b>Përmbajtja</b>	
Raporti i audituesit të pavarur.....	1
Pasqyra e pozicionit financiar .....	1
Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse .....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	3
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare.....	4
1. Të përgjithshme.....	5
2. Baza e përgatitjes.....	5
3. Deklarata e përputhshmërisë .....	5
4. Paraqitja e pasqyrave financiare.....	5
5. Ndryshimet në politikat kontabël dhe dhënie e informacioneve shpjeguese .....	6
6. Përmbledhje e politikave kontabël .....	7
7. Standartet e nxjerra por ende jo efektive.....	27
8. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël.....	28
9. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre .....	33
10. Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore.....	34
11. Huatë dhe parapagime ndaj institucioneve financiare.....	34
12. Investime në letrat me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse .....	34
13. Hua dhe paradhënie për klientët, neto .....	35
14. Aktive të tjera.....	41
15. Aktive afatgjata materiale .....	42
16. Aktive me të drejtë përdorimi .....	43
17. Aktive afatgjata jomateriale.....	43
18. Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore .....	44
19. Detyrime ndaj institucioneve financiare.....	44
20. Detyrime ndaj klientëve.....	45
21. Detyrime të qirasë.....	46
22. Detyrime të tjera.....	47
23. Borxhi i varur .....	48
24. Provizionet për detyrimet dhe të tjera.....	48
25. Aktive tatimore te shtyra, neto .....	49
26. Kapitali aksionar .....	49
27. Rezerva.....	50
28. Të ardhura nga interesat me normë efektive të interesit.....	50
29. Shpenzime për interesat me normë efektive të interesit .....	50
30. Të ardhura nga komisionet.....	51
31. Shpenzime për komisionet.....	51
32. Rimarrje / (humbje) të pritshme kreditore për aktivet financiare.....	51
33. Shpenzime personeli .....	52
34. Rimarrje neto nga provizione të tjera .....	52
35. Shpenzime administrative .....	53
36. Tatimi mbi fitimin .....	53
37. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara .....	54
38. Transaksionet me palët e lidhura .....	56
39. Ngjarjet pas dates së raportimit .....	57
40. Analiza e aktiveve dhe detyrimeve sipas maturitetit .....	58
41. Administrimi i rrezikut financiar .....	<u>59-105</u>

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin e Banka OTP Albania sh.a

Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka OTP Albania sh.a (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2023, pasqyrën e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2023, dhe performancën financiare dhe flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

### Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Informacione të tjera të përfshira në Raportin Vjetor 2023 të Banka OTP Albania sh.a

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2023, përparësi në përputhje me nenet 17, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2023 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

## **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

## **Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Bankës të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Banka OTP Albania sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar  
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Albania  
13 qershor 2024  
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel  
Auditues Ligjor

**OTP BANK ALBANIA SH.A.***(te gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek)***Pasqyra e pozicionit financiar  
më 31 dhjetor 2023**

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<b>Aktivët</b>			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	9	20,547,198	17,779,996
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	10	14,213,819	14,954,227
Hua dhe parapagime ndaj institucioneve financiare	11	894,030	627,752
Investime në letra me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	12	27,713,277	32,545,181
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	12.1	10,484,224	3,151,358
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	13	93,413,612	99,925,011
Qiratë financiare të arkëtueshme	13.1	1,540,095	1,232,223
Aktive të tjera	14	1,685,703	680,369
Aktive afatgjata materiale	15	4,967,234	3,520,252
Aktive me të drejtë përdorimi	16	1,323,193	1,224,401
Aktive afatgjata jomateriale	17	392,315	495,304
Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore	18	113,488	187,412
Aktive tatimore të shtyra, neto	25	49,772	310,265
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>177,337,960</b>	<b>176,633,751</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj institucioneve financiare	19	2,166,715	8,636,055
Detyrime ndaj klientëve	20	148,343,661	147,376,492
Detyrime të qirasë	21	1,202,301	1,214,070
Borxhi i varur	23	775,526	-
Detyrime të tjera	22	2,819,846	1,874,217
Provizione për detyrime dhe të tjera	24	303,292	433,910
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>155,611,341</b>	<b>159,534,744</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	26	6,740,900	6,740,900
Primi i lidhur me aksionin		1,750	1,750
Rezerva	27	6,520,246	4,863,651
Fitim i pashpërndarë		8,463,723	5,492,706
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>21,726,619</b>	<b>17,099,007</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>177,337,960</b>	<b>176,633,751</b>

Pasqyrat e pozicionit financiar duhen lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në 105, të cilat janë pjesë perberese e ketyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtuesit e Bankës më 30 Maj 2024 dhe janë nënshkruar në emër të saj nga:

Bledar Shella  
Drejtore Ekzekutive



Attila Kovacs  
Drejtore i Divizionit të Financës

**OTP BANK ALBANIA SH.A.***((te gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek))***Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
Të ardhura nga interesat me normë efektive të interesit	28	8,945,985	4,855,233
Shpenzime për interesat me normë efektive të interesit	29	(1,051,413)	(547,232)
<b>Marzhi neto nga interesat dhe të ardhurat e ngjashme</b>		<b>7,894,572</b>	<b>4,308,001</b>
Të ardhura nga komisionet	30	1,535,037	1,138,551
Shpenzime nga komisionet	31	(565,836)	(415,400)
<b>Të ardhura neto nga komisionet</b>		<b>969,201</b>	<b>723,151</b>
<b>Rimarrje /(humbje) të pritshme të kredisë për aktivet financiare</b>	<b>32</b>	<b>229,058</b>	<b>1,065,148</b>
Fitim nga kurset e këmbimit, neto		333,488	167,387
Humbja neto nga shitja e aktiveve VDATGj	12	(38,152)	-
Humbja neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(51,910)	(32,901)
Fitimi neto nga shitja e aktiveve të riposeduara		40,801	13,152
Fitim/(humbje) të tjera, neto		(8,862)	2,499
<b>Të ardhura të tjera, neto</b>		<b>275,365</b>	<b>150,137</b>
Shpenzimet personeli	33	(1,840,431)	(1,130,277)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	15	(196,368)	(106,578)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	17	(155,781)	(79,286)
Zhvlerësimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	16	(325,286)	(177,934)
Shpenzime administrative	35	(2,830,885)	(1,062,512)
Rimarrje neto nga provizione të tjera	34	67,605	69,033
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(5,281,146)</b>	<b>(2,487,554)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>4,087,050</b>	<b>3,758,883</b>
Tatimi mbi fitimin	36	(697,678)	(626,039)
Të ardhura /(shpenzime) tatimore te shtyra	25	(9,831)	18,550
<b>Fitimi i vitit, neto</b>		<b>3,379,541</b>	<b>3,151,394</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>			
<i>Zërat që mund të riklasifikohen në periudhat e ardhshme në fitim ose humbje:</i>			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të mbajtura me VDATGj, neto nga tatimi		1,248,070	(2,102,127)
<b>Të ardhura/(humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga tatimet</b>		<b>1,248,070</b>	<b>(2,102,127)</b>
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga tatimi</b>		<b>4,627,611</b>	<b>1,049,267</b>

*Pasqyrat e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 105, të cilat janë pjesë përbërëse e ketyre pasqyrave financiare.*

**OTP BANK ALBANIA SH.A.***(amounts in '000 Lek)***Pasqyra e ndryshimeve në kapital  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Primi i aksioneve</b>	<b>Rezerva ligjore dhe rregullatore</b>	<b>Rezerva për vlerën e drejtë</b>	<b>Rezerva e bashkimit</b>	<b>Fitimi i pashpërndarë</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	<b>6,740,900</b>	<b>1,750</b>	<b>1,197,808</b>	<b>914,782</b>	-	<b>2,436,928</b>	<b>11,292,168</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>							
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	3,151,394	<b>3,151,394</b>
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me VDATGj	-	-	-	(2,102,127)	-	-	<b>(2,102,127)</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>				<b>(2,102,127)</b>		<b>3,151,394</b>	<b>1,049,267</b>
Rezerva e bashkimit nga blerja e Alpha Bank Albania (Shënimi 8.1)	-	-	-	-	4,757,573	-	<b>4,757,573</b>
Alokimi i fitimit të pashpërndarë në rezervë ligjore (Shënimi 27 (i))	-	-	95,615	-	-	(95,615)	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>6,740,900</b>	<b>1,750</b>	<b>1,293,423</b>	<b>(1,187,345)</b>	<b>4,757,573</b>	<b>5,492,707</b>	<b>17,099,008</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>							
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	3,379,541	<b>3,379,541</b>
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me VDATGj	-	-	-	1,248,070	-	-	<b>1,248,070</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>				<b>1,248,070</b>		<b>3,379,541</b>	<b>4,627,611</b>
Alokimi i fitimit të pashpërndarë në rezervë ligjore (Shënimi 27 (i))	-	-	408,526	-	-	(408,526)	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>6,740,900</b>	<b>1,750</b>	<b>1,701,948</b>	<b>60,725</b>	<b>4,757,573</b>	<b>8,463,723</b>	<b>21,726,619</b>

*Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 105, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Shënime në pasqyrat financiare***(shuma në Lek'000, përveç rasteve kur thuhet ndryshe)***Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare**

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
<b>Flukset e mjeteve monetare nga aktiviteti operativ:</b>		
Fitimi para tatimit	4,087,050	3,758,883
<i>Rregullime për të kuadruar aktivet neto me flukseve monetare nga veprimtaritë operative:</i>		
Zhvlerësimi	<b>15</b> 196,368	106,578
Amortizimi	<b>17</b> 155,781	79,286
Zhvlerësimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	<b>16</b> 325,286	177,934
Zhvlerësimi/(rimarrje) e aktiveve financiare	<b>32</b> (229,058)	(1,065,148)
Rënie në vlerë mbi aktivet e marra në rrugë ligjore	<b>18</b> 43,829	768
Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	51,910	32,901
Fitimi neto nga shitja e aktiveve të marra në rrugë ligjore	(40,801)	(13,152)
Efekte të tjera rivlerësimi	423,423	(195,656)
Të ardhura nga interesat	<b>28</b> (8,945,985)	(4,855,233)
Shpenzime nga interesat	<b>29</b> 1,051,413	547,232
<b>Fitimi operativ para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>	<b>(2,880,784)</b>	<b>(1,425,607)</b>
<i>Ndryshim në aktivet dhe pasivet operative:</i>		
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	740,408	(36,058)
Hua dhe paradhënie për institucionet financiare	(266,278)	14,239,947
Hua dhe paradhënie për klientët	6,396,527	(3,796,542)
Aktive të tjera	(1,005,334)	(475,804)
Detyrime ndaj institucioneve financiare dhe bankave	(402,376)	(455,509)
Detyrime ndaj klientëve	967,169	3,228,690
Detyrime të tjera	945,629	(347,040)
Të ardhura nga shitja e kolateraleve të riposeduara	66,359	15,637
Interesi i arkëtuar	8,936,473	4,710,174
Interesi i paguar	(1,334,873)	(605,120)
Tatim fitimi i paguar	(690,000)	(476,590)
<b>Flukset neto te mjeteve monetare gjeneruar nga aktivitetet operative</b>	<b>11,472,920</b>	<b>14,576,178</b>
<b>Flukset e mjeteve monetare nga aktiviteti investuese:</b>		
Blerje e aktiveve financiare me VDATGj	(7,560,897)	(2,725,000)
Të ardhura nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe riblerjet e letrave me vlerë të mbajtura me VDATGj	6,975,204	2,903,200
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	(31,398)	(8,725)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(1,762,730)	(2,699,536)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	99,113	32,706
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre të marra nga bashkimi (8.1)	-	4,408,467
<b>Flukset neto te mjeteve monetare të gjeneruar / (përdorur) për aktivitetin investuese</b>	<b>(2,280,708)</b>	<b>1,911,112</b>
<b>Flukset e mjeteve monetare nga aktiviteti financuese:</b>		
Borxhi i varur	775,526	-
Pagesat e principalit të detyrimeve të qirasë	<b>21</b> (352,428)	(207,671)
Shlyerje e huamarrjeve	(6,066,964)	(8,335,123)
<b>Fluksi neto te mjeteve monetare përdorur për aktivitetin financuese</b>	<b>(5,643,866)</b>	<b>(8,542,794)</b>
<b>Rritje neto të mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre</b>	<b>3,548,346</b>	<b>7,944,496</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit</b>	<b>17,779,996</b>	<b>9,382,469</b>
Efekt neto nga ndryshimi i kursit të mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre	(781,144)	453,030
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit</b>	<b>9</b> <b>20,547,198</b>	<b>17,779,996</b>

*Pasqyra e fluksi të mjeteve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 105, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare*



# OTP BANK ALBANIA SH.A.

## Shënime në pasqyrat financiare

(shuma në Lek'000, përveç rasteve kur thuhet ndryshe)

### 1. Të përgjithshme

Banka OTP Albania Sh.a, ("Banka") është një institucion financiar shqiptar i themeluar më 12 dhjetor 2003 sipas ligjit shqiptar mbi shoqëritë tregtare dhe u liçensua nga Banka e Shqipërisë ("Banka Qendrore") më 16 shkurt 2004 (vendimi nr.17) që të operojë si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me ligjin Nr.8365 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i muajit Korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i ligjit Nr. 8269, i dhjetorit 1997, "Mbi Bankën e Shqipërisë". Banka ka filluar aktivitetin më 1 mars 2004. OTP Bank NYRT është mëma përfundimtare e Grupit.

Në datën 1 dhjetor 2022, Banka dhe "Alpha Bank Albania" sh.a." (e njohur edhe si "ABA") u bashkuan ligjërisht duke inkorporuar aktivet dhe detyrimet me Bankën. Përpara bashkimit, Banka dhe ABA ishin nën kontrollin e përbashkët të OTP Bank NYRT duke qenë i njëjti dhe aksioneri i vetëm që nga 18 korrik 2022 kur OTP Bank NYRT bleu ABA-n. Banka dhe aksioneri i ABA miratuan termat dhe kushtet e bashkimit më 1 dhjetor 2022 pas miratimit paraprak rregullator të marrë më 23 nëntor 2022.

Më 31 dhjetor 2023, Banka ka operuar përmes zyrave qendrore që ndodhen në Tiranë dhe 49 degëve të saj (2022: 61 degë). Banka ushtron aktivitetin vetëm brenda territorit gjeografik të Shqipërisë. Më 31 dhjetor 2023 Banka kishte 748 punonjës (31 dhjetor 2022: 819 punonjës). Zyra e regjistruar e Bankës është pranë Kullat Binjake, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kulla 1, Kati 9, Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2023, Këshilli Mbikqyrës dhe Komiteti i Kontrollit të Bankës përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Bordi Mbikqyrës	Gabor Kolics	Kryetar
	Ilir Ciko	Anëtar
	Stavri Pashko	Anëtar
	Örs Levente Szilágyi	Anëtar
	Orsolya Csilla Kovács	Anëtar
	Armando Duka	Anëtar
	Janos Veres	Anëtar
Komiteti i Auditimit	Stavri Pashko	Kryetar
	Jitka Pantůčková	Anëtar
	Zoltan Molnar	Anëtar

### 2. Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGj") të aktiveve financiare që janë matur me vlerën e drejtë dhe kolateraleve të riposeduara të cilat maten me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Pasqyrat financiare paraqiten në lekë ("Lek") dhe të gjitha vlerat janë të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur tregohet ndryshe. Pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e vazhdimësisë, pasi drejtimi është i kënaqur që Banka ka burime të mjaftueshme për të vazhduar si vijimësi për të ardhmen e parashikueshme. Në bërjen e këtij vlerësimi, menaxhimi ka marrë në konsideratë një gamë të gjerë informacioni duke përfshirë parashikimet e përfitueshmërisë, kërkesat rregullatore për kapital dhe nevojat për financim. Vlerësimi përfshin gjithashtu shqyrtimin e skenarëve të arsyeshëm të mundshëm ekonomikë dhe ndikimet e tyre të mundshme në rentabilitetin, kapitalin dhe likuiditetin e Bankës dhe shoqërisë mëmë të saj.

#### 2.1 Të dhëna krahasuese

Një riklasifikim i caktuar është bërë me qëllim që të sigurohet një prezantim dhe shpalosje më e mirë informacioni shpjegues në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022. Më konkretisht: "Ulje në vlerën neto të realizueshme" e Aktive të riposeduara dhe "Provizioni për çështjet gjyqësore dhe rreziqe të tjera operationale, neto" prej 69,033 mijë lekë u paraqit nën "Të ardhura/shpenzime të tjera neto" në pasqyrën e fitim/humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për fundin e vitit 31 dhjetor 2022, dhe për të dyja periudhat 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 këto janë paraqitur në një linjë të veçantë "Rimarrje neto nga provizione të tjera" (Shënimit 34).

### 3. Deklarata e përputshmërisë

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

### 4. Paraqitja e pasqyrave financiare

Banka paraqet pasqyrën e saj të pozicionit financiar sipas likuiditetit bazuar në synimin dhe aftësinë e perceptuar të Bankës për të rikuperuar/shlyer pjesën më të madhe të aktiveve/detyrimeve të zërit përkatës të pasqyrës financiare. Një analizë në lidhje me rikuperimin ose shlyerjen brenda 12 muajve pas datës së raportimit (aktuale) dhe më shumë se 12 muajve pas datës së raportimit (jo aktuale) është paraqitur në Shënimin 40.

## **5. Ndryshimet në politikat kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese**

### **Standarde dhe interpretime të reja dhe të ndryshuara.**

Banka nuk ka miratuar më herët ndonjë standard të ri, interpretim apo ndryshim që është nxjerrë por nuk është ende efektiv në periudhën raportuese korrente. Ndryshime dhe interpretime të tjera zbatohen për herë të parë në vitin 2023, por nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës, të përshkruara shkurtimisht më poshtë:

- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe Deklarata e Praktikave të SNRF 2: Shpalosja e politikave kontabël (Amendime).** Amendimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2023. Amendimet ofrojnë udhëzime për zbatimin e gjykimeve të materialitetit në dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël. Në veçanti, amendimet në SNK 1 zëvendësojnë kërkesën për të shpalosur politikat kontabël 'të rëndësishme' me një kërkesë për të shpalosur politikat kontabël 'materiale'. Gjithashtu, udhëzues dhe shembuj ilustrues shtohen në Deklarimin e Praktikës për të ndihmuar në zbatimin e konceptit të materialitetit kur bëhen gjykime në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël. Amendimet kanë pasur ndikim në dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël të Bankës, por jo në matjen, njohjen ose paraqitjen e ndonjë zëri në pasqyrat financiare të Bankës.

- **SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Amendime).** Amendimet hyjnë në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 dhe zbatohen për ndryshimet në politikat kontabël dhe ndryshimet në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe. Amendimet prezantojnë një përkufizim të ri të vlerësimeve kontabël, të përcaktuara si shuma monetare në pasqyrat financiare që i nënshtrohen pasigurisë në matje, nëse ato nuk rezultojnë nga një korrigjim i gabimit të periudhës së mëparshme. Gjithashtu, amendimet në vlerësimet kontabël qartësojnë se cilat janë ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe si vlerësohen këto nga ndryshimet në politikat kontabël dhe korrigjimet e gabimeve. Amendimet nuk kishin ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

- **SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat: Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Amendime).** Amendimi është efektiv për periudhën raportuese filluar në ose pas janarit 2023. Amendimi ngushton fushëveprimin dhe jep qartësi të mëtejshme mbi përjashtimin e njohjes fillestare sipas SNK 12 dhe specifikon se si kompanitë duhet të llogarisin tatimin e shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm, të tilla si qiratë dhe detyrimet e dekomisionimit. Amendimet qartësojnë se kur pagesat që shlyejnë një detyrim janë të zbritshme për qëllime tatimore, është çështje gjykimi, duke pasur parasysh ligjin tatimor në fuqi, nëse këto zbritje i atribuohen për qëllime tatimore detyrimit ose përbërësit të aktivit përkatës. Sipas amendimeve, përjashtimi i njohjes fillestare nuk zbatohet për transaksionet që, në njohjen fillestare, krijojnë diferenca të përkohëshme të barabarta të tatueshme dhe të zbritshme. Ai zbatohet vetëm nëse njohja e një aktivit me qira dhe pasivi i qirasë (ose pasivi i dekomisionimit dhe komponenti i aktivit të dekomisionimit) sjellin diferenca të përkohëshme të tatueshme dhe të zbritshme që nuk janë të barabarta. Amendimet nuk kishin ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

- **SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat: Reforma Tatimore Ndërkombëtare - Rregulla Modeli i Shtyllës së Dytë (Amendimet).** Amendimet hyjnë në fuqi menjëherë pas lëshimit, por disa kërkesa për paraqitjen e informacionit hyjnë në fuqi më vonë. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik publikoi rregullat e modelit të Shtyllës së Dytë në dhjetor 2021 për të siguruar që kompanitë e mëdha shumëkombëshe do t'i nënshtrohen një norme tatimore minimale prej 15%. Më 23 maj 2023, BSNK publikoi Reformën Ndërkombëtare Tatimore - Rregullat Modeli të Shtyllës së Dytë – Ndryshimet në SNK 12. Amendimet paraqesin një përjashtim të përkohshëm të detyrueshëm në kontabilitetin për tatimet e shtyra që rrjedhin nga zbatimi juridiksional i rregullave të modelit të Shtyllës së Dytë dhe kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese për subjektet e prekura mbi ekspozimin e mundshëm ndaj taksave mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë. Amendimet kërkojnë, për periudhat në të cilat legjislacioni i Shtyllës së Dytë është miratuar (në thelb), por ende jo në fuqi, dhënie informacionesh shpjeguese të informacionit të njohur ose të arsyeshëm të vlerësuar që ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë ekspozimin e njësisë ekonomike që rrjedh nga tatimet mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë. Dhënia e informacioneve shpjeguese për shpenzimet aktuale tatimore lidhur me tatimet mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me periudhat përpara se legjislacioni të hyjë në fuqi kërkohen për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023, por nuk kërkohen për asnjë periudhë të ndërmjetme që përfundon më ose para datës 31 dhjetor 2023. Banka ka vlerësuar se nuk do të jetë subjekt i tatimeve të Shtyllës së Dytë kur legjislacioni të hyjë në fuqi pasi norma e saj tatimore efektive është 15%. Prandaj, duke qenë se nuk kërkohen dhënie informacionesh shpjeguese për Shtyllën e Dytë, amendimet nuk do të kenë ndikim në pasqyrat financiare të bankave më 31 dhjetor 2023.

**5. Ndryshimet në politikat kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese (vazhdim)****Standarde dhe interpretime të reja dhe të ndryshuara (vazhdim)****• SNRF 17: Kontratat e sigurimit**

Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023. Ky është një standard i ri gjithëpërfshirës i kontabilitetit për kontratat e sigurimit, që mbulon njohjen dhe matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese. SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit të lëshuara, si dhe për garancitë dhe instrumentet financiare të caktuara me kontrata pjesëmarrjeje diskrecionale. Përveç përjashtimeve të përshkruara më poshtë, Banka nuk ka identifikuar kontrata që rezultojnë në transferimin e rrezikut të rëndësishëm të sigurimit, dhe për këtë arsye ka arritur në përfundimin se SNRF 17 nuk ka një ndikim material në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023.

Si pjesë e këtij përcaktimi, Banka vlerësoi kontratat e huasë që plotësojnë përkufizimin e një kontrate sigurimi, por kufizojnë kompensimin për ngjarjet e siguruara në shumën që kërkohet ndryshe për të shlyer detyrimin e mbajtësit të policës së krijuar nga kontrata, p.sh. një hua me falje deri në vdekje hamarrësi, ekziston një zgjedhje për të zbatuar ose SNRF 9 ose SNRF 17 për kontrata të tilla. Kjo zgjedhje bëhet në nivel portofoli dhe është e përvokueshme. Banka ka bërë një zgjedhje të përvokueshme për të zbatuar SNRF 9 për çdo portofol të këtyre produkteve.

**6. Përmbledhje e politikave kontabël**

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare nga Banka. Për më tepër, Banka miratoi dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës SNRF 2) nga 1 janari 2023. Ndryshimet kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël 'materiale' dhe 'jomateriale'. Amendimet nuk rezultuan në ndonjë ndryshim në vetë politikat kontabël dhe nuk ndikuan në mënyrë thelbësore në informacionin e politikave kontabël.

**(a) Transferimi i interesit të kontrollit në njësitë ekonomike nën kontroll të përbashkët**

Bashkimi me Alpha Bank i përshkruar në detaje në shënimin 8.1 është një kombinim biznesi i njërive ekonomike nën kontroll të përbashkët jashtë objektit të SNRF 3 Kombinimet e Biznesit. Në mungesë të udhëzimeve specifike nga SNRF, njësitë ekonomike të përfshira në transaksionet e kontrollit të përbashkët u kërkohet të zhvillojnë një politikë kontabël të përshtatshme, që do të zbatohet vazhdimisht, duke përdorur hierarkinë e përshkruar në SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimin Kontabël dhe Gabimet.

Drejtimi ka zgjedhur të llogarisë transfertat e kontrollit të interesit në subjektet që janë nën kontrollin e aksionerit që kontrollojnë Bankën duke përdorur metodën e grupimit të interesit. Në zbatimin e kësaj metode, aktivet dhe detyrimet e blera njihen me vlerat kontabël (vlerat e librave) të njohura më parë në pasqyrat financiare individuale të njësisë ekonomike të blerë dhe aktivet neto korresponduese njihen në zërat e kapitalit neto si rezervë e bashkimit.

Pasqyrat financiare pasqyrojnë rezultatet e kombinimit të njërive ekonomike duke përfshirë njësinë ekonomike të bashkuar në datën e kombinimit ligjor. Kjo politikë është aplikuar në mënyrë konsistente dhe do të zbatohet për të gjitha transaksionet e ardhshme të ngjashme.

**(b) Monedha funksionale dhe raportuese**

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek shqipëtar ("Lek"), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Bankës.

**(c) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin e datës së raportimit. Fitimi ose Humbja në valutë të huaj nga instrumentet financiare me kosto të amortizuar, është diferenca midis koston së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe koston së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundvitit.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
USD	93.94	107.05
EUR	103.88	114.23

## **6. Përmbledhje e politikave të kontabilitetit (vazhdim)**

### **(d) Interesi**

#### ***Metoda e normës efektive të interesit***

Të ardhurat nga interesi regjistrohen duke përdorur metodën e interesit efektiv (NEI) për të gjithë instrumentat financiarë të matur me koston e amortizuar, duke përfshirë qiranë financiare. Të ardhurat nga interesi nga instrumentat e borxhit të mbajtur me VDATGj gjithashtu regjistrohen duke përdorur metodën NEI. Shpenzimet e interesit llogariten gjithashtu duke përdorur metodën NEI për të gjitha detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar. NEI është norma që pikërisht aktualizon flukset e ardhshme të parave përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose, kur është e përshtatshme, në një periudhë më të shkurtër, në vlerën kontabël neto të aktivit financiar.

NEI (dhe për këtë arsye, kostoja e amortizuar e aktivit) llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose prim për blerjen, tarifat dhe kostot që janë pjesë përbërëse e NEI. Banka njih të ardhurat nga interesi duke përdorur një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një normë konstante kthimi gjatë jetës së pritshme të huasë. Prandaj, Banka njih efektin e normave të interesit potencialisht të ndryshme të ngarkuara në fazë të ndryshme dhe karakteristikave të tjera të ciklit të jetës së produktit (përfshirë parapagimet, interesat e penaliteve dhe gjokat).

Nëse pritshmëritë e flukseve monetare të aktiveve ose detyrimeve financiare me normë fikse rishikohen për arsye të tjera përveç rrezikut të kredisë, atëherë ndryshimet në flukset monetare të ardhshme kontraktuale skontoohen me NEI origjinale me një rregullim në vijim në vlerën kontabël. Diferenca nga vlera kontabël e mëparshme regjistrohet si një sistemim pozitiv ose negativ në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar në bilanc me një rritje ose ulje përkatëse në të ardhurat/shpenzimet nga interesi i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Për instrumentet financiare me normë të ndryshueshme interesi, rivlerësimi periodik i flukseve monetare për të reflektuar lëvizjet në normat e interesit të tregut ndryshojnë gjithashtu normën efektive të interesit, por kur instrumentet financiare u njohën fillimisht në një shumë të barabartë me principalin, rivlerësimi i pagesave të ardhshme të interesit nuk ndikon ndjeshëm vlerën kontabël të aktivit ose e detyrimit.

#### ***Interesa dhe të ardhura/shpenzime të ngjashme***

Të ardhurat nga veprimtaritë bankare, duke përfshirë të ardhurat nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve, të ardhurat nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, njihen në fitim ose humbje duke zbatuar NEI në vlerën kontabël bruto të aktiveve financiare, përveç aktiveve të zhvlerësuara.

Kur një aktiv financiar zhvlerësohet dhe për këtë arsye konsiderohet si 'Standarti 3' (shiko shënim 6 (j) (vi) A), Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke zbatuar NEI në koston e amortizuar neto të aktivit financiar. Nëse mjetet financiare trajtohen (siç është përshkruar në Shënimin 41.b) dhe nuk kanë zhvlerësim Banka kthehet në llogaritjen e të ardhurave nga interesi në baza bruto.

Për aktivet financiare të zhvlerësuara që në blerje ose në krijim (POCI) (siç është përshkruar në shënimin 41.b), Banka llogarit të ardhura nga interesi duke llogaritur normën efektive të interesit të rregulluar dhe duke zbatuar atë normë në koston e amortizuar të aktivit financiar. Norma Efektive e Interesit e rregulluar është norma e interesit që, në njohjen fillestare, aktualizon flukset monetare të ardhshme të vlerësuara (duke përfshirë humbjet e kredisë) në koston e amortizuar të aktiveve të zhvlerësuara që në blerje ose në krijim (POCI).

Banka shpalos interesin e paguar për këto aktive financiare si shpenzim interesi, me dhënie informacionesh shpjeguese shtesë në shënimin 28.

Të ardhurat nga interesi nga qiraja financiare njihen gjatë afatit të qirasë duke përdorur metodën e investimit neto (para tatimit), e cila pasqyron një normë konstante periodike kthimi / duke aplikuar normën e nënkuptuar në qira për (i) vlerën kontabël bruto të qirasë të arkëtueshme në fazën 1 dhe 2 dhe (ii) vlerën kontabël neto të llogarive të arkëtueshme të qirasë në fazën 3 të modelit HPK.

Të ardhurat nga qiratë regjistrohen brenda të ardhurave nga interesi duke përdorur metodën e interesit efektiv në fitim ose humbje.

**6. Përmbledhje e politikave të kontabilitetit (vazhdim)**

**(e) Tarifa dhe komisione**

Banka fiton të ardhura nga tarifat dhe komisionet nga një gamë e ndryshme shërbimesh që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet njihen në një vlerë që pasqyron shumën për të cilën Banka pret të ketë të drejtë në këmbim të ofrimit të shërbimeve. Detyrimet e ekzekutimit, si dhe koha e përmbushjes së tyre, identifikohen dhe përcaktohen në fillim të kontratës. Kontratat e të ardhurave të Bankës nuk përfshijnë detyrime të shumëfishta të performancës, siç shpjegohet më tej në Shënimet A dhe B më poshtë.

Kur Banka ofron një shërbim për klientët e saj, shuma faturohet dhe në përgjithësi duhet të paguhet menjëherë me kënaqësinë e një shërbimi të ofruar në një moment kohor ose në fund të periudhës së kontratës për një shërbim ofruar me kalimin e kohës.

Banka në përgjithësi ka arritur në përfundimin se ajo është kryesore në marrëveshjet e saj të të ardhurave, sepse zakonisht kontrollon shërbimet përpara se t'i transferojë ato te klienti.

**A. Të ardhurat nga tarifat e fituara nga shërbimet që ofrohen gjatë një periudhe të caktuar kohore**

Tarifat dhe komisionet e fituara nga ofrimi i shërbimeve gjatë një periudhe kohore janë grumbulluar gjatë asaj periudhe. Këto tarifa përfshijnë të ardhurat nga komisionet, duke përfshirë tarifat e shërbimit të llogarisë, tarifat e menaxhimit të investimeve dhe tarifat e vendosjes.

**B. Të ardhurat nga tarifat nga ofrimi i shërbimeve financiare dhe të fituara për ekzekutimin e një akti të rëndësishëm**

Tarifat dhe komisionet që dalin nga negociimi ose pjesëmarrja në negociimin e një transaksioni me një palë të tretë, siç janë tarifat e tjera dhe shpenzimet e komisioneve që lidhen kryesisht me tarifat e transaksionit dhe shërbimit, njihen pas përfundimit të transaksionit bazë. Tarifat ose komponentët e tarifave që lidhen me një performancë të caktuar njihen pas plotësimit të kriterëve përkatëse.

**C. Të ardhurat nga tarifat që përbëjnë një pjesë integrale të instrumentit financiar korrespondues**

Tarifat që Banka konsideron të jenë pjesë përbërëse e instrumentave financiarë përkatëse përfshijnë: tarifat e marrjes së huasë, pagesat e angazhimit të kredisë për huatë që ka gjasa të tërhiqen dhe tarifat e tjera të lidhura me kredinë. Njohja e këtyre tarifave (së bashku me kostot shtesë) përbëjnë një pjesë integrale të instrumentave financiarë përkatëse dhe njihen si të ardhura nga interesi nëpërmjet një rregullimi në NEI.

Përfundim është, kur nuk ka gjasa që një kredi të tërhiqet, tarifat e angazhimit të huasë njihen si të ardhura me skadim. Detyrimet e huasë që janë në kuadër të qëllimit të SNRF 9 (dmth., janë përcaktuar me VDPFH ose janë nën një normë interesi të tregut, ose janë përcaktuar neto) llogariten si derivativë dhe maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

## **6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **(f) Qiraja**

Banka vlerëson në fillimin e kontratës nëse një kontratë është ose përmban një qira. Kjo do të thotë, nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohore në këmbim të shumës.

#### **i. Banka që vepron si qiramarrës**

Kontabilizimi i qirave nga Banka si qiramarrës.

Si qiramarrës, Banka merr me qira disa ambiente për zyra dhe degë, pasuri të patundshme, pajisje dhe makina. Qiratë njihen si një aktiv me të drejtë përdorimi dhe një detyrim përkatës në datën në të cilën aktivi i dhënë me qira është i disponueshëm për përdorim nga Banka. Çdo pagesë e qirasë ndahet ndërmjet detyrimit dhe koston financiare. Kostoja financiare ngarkohet në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojë një normë konstante periodike interesi për pjesën e mbetur të detyrimit për secilën periudhë. Aktivi me të drejtën e përdorimit njihet me kosto dhe zhvlerësohet për më pak se jeta e dobishme e aktivit dhe afati i qirasë mbi një bazë lineare. Detyrimet që rrjedhin nga një qira maten fillimisht mbi bazën e vlerës aktuale. Detyrimet e qirasë përfshijnë vlerën aktuale neto të pagesave të mëposhtme të qirasë:

- pagesat fikse (duke përfshirë këtu dhe pagesat fikse në-thelb), duke zbritur çdo stimul qiraje të arkëtueshme;
- pagesat variabël të qirasë të cilat varen nga një indeks ose normë;
- shumat e pritshme për t'u paguar sipas vlerës së mbetur të garancisë;
- çmimi i ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse Banka ka siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë opsion, dhe
- pagesat e gjobave për përfundimin e parakohshëm të qirasë, përveç nëse Banka ka siguri të arsyeshme që nuk do të përfundojë kontratën para kohe.

Pagesat e qirasë skontohe duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet, përdoret norma rritëse e huamarrjes së qiramarrësit, që është norma që qiramarrësi duhet të paguajë për të marrë hua fondet e nevojshme për të marrë një aktiv me vlerë të ngjashme në një mjedis të ngjashëm ekonomik me terma dhe kushte të ngjashme.

Pagesat nën qira afatgjata të tokës bazuar në vlerën kadastrale të tokës trajtohen si pagesa variabël të qirasë që nuk bazohen në një indeks ose një normë.

Kosto e aktivit me të drejtë përdorimi do të përfshijë:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë
- çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit, minus çdo stimul qiraje të marë;
- çdo kosto fillestare të drejtpërdrejtë të kryer nga qiramarrësi; dhe
- kostot e restaurimit

Në përcaktimin e afatit të qirasë, drejtimi i Bankës merr në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat që krijojnë një nxitje ekonomike për të ushtruar një opsion zgjatjeje ose për të mos ushtruar një opsion përfundimi. Opsionet e zgjatjes (ose periudhat pas opsioneve të përfundimit) përfshihen në afatin e qirasë vetëm nëse qiraja është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do të zgjatet (ose nuk do të përfundojë). Vlerësimi rishikohet nëse ndodh një ngjarje e rëndësishme ose një ndryshim i rëndësishëm në rrethana që ndikon në këtë vlerësim dhe që është nën kontrollin e qiramarrësit.

#### **ii. Banka që vepron si qiradhënës**

Kur aktivet jepen me qira nën një qira operative, pagesat e arkëtueshme të qirasë njihen si të ardhura nga qiraja mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Banka shet në mënyrë rutinore aktivet e mbajtura për qira nën qira operative kur përfundojnë qiratë. Aktive të tilla transferohen në inventarë në vlerën e tyre kontabël kur ato pushojnë të merren me qira. Të ardhurat nga shitja njihen si të ardhura me koston përkatëse të mallrave të shitura. Më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, Banka nuk ka vepruar si qiradhënës.

Banka është e ekspozuar ndaj qirave financiare si qiradhënëse dhe politika kontabël është shpalosur në Shënimin 6(m).

### **(g) Shpenzimet Operative**

Shpenzimet operative regjistrohen atëherë kur ato ndodhin.

**6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(h) Përfitimet e punonjësve**

*(i) Plani i përcaktuar i kontributeve*

Detyrimet për kontribute në planet e pensioneve me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse kur ato duhet të paguhen. Banka ushtron vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që ofrojnë përfitime pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet vendore janë përgjegjëse për sigurimin e kufirit minimal të përcaktuar ligjërisht për pensionet në Shqipëri sipas një plani pensioni me kontribute të përcaktuara.

*(ii) Përfitimet afatshkurtra*

Detyrimet për përfitime afatshkurtra të punonjësve maten mbi baza të paskontuara dhe njihen si shpenzime pasi ofrohet shërbimi i lidhur. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet nën bonusin afatshkurtër të parave ose planet e ndarjes së fitimit nëse Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të mëparshme të ofruar nga punëmarrësi dhe detyrimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme

*(iii) Përfitime të tjera afatgjata të punonjësve*

Detyrimi neto i Bankës në lidhje me përfitimet afatgjata të punonjësve është shuma e përfitimit të ardhshëm që punonjësit kanë fituar në këmbim të shërbimit të tyre në periudhat aktuale dhe të mëparshme. Ky përfitim skontohe për të përcaktuar vlerën e tij aktuale. Rivlerësimet njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato lindin.

*(iv) Përfitimet e ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit*

Përfitimet e ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit njihen si shpenzime në kohën më të hershme kur Banka nuk mund të tërheqë më ofertën e këtyre përfitimeve dhe kur Banka njuh kostot për një ristrukturim. Nëse përfitimet nuk pritet të shlyhen tërësisht brenda 12 muajve nga data e raportimit, atëherë ato skontohen.

Vlera e drejtë e shumës së pagueshme për punonjësit, të cilat shlyhen në para, njihet si shpenzim me një rritje korresponduese të detyrimeve, për periudhën gjatë së cilës punonjësit kanë të drejtën e marrjes së pagesës. Detyrimi rivlerësohet në çdo datë raportimi dhe në datën e shlyerjes. Çdo ndryshim në detyrim njihet si shpenzime të personelit në fitim ose humbje.

**(i) Shpenzimet e tatimit mbi fitimin**

Shpenzimet e Tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit.

*(i) Tatimi aktual*

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshme ose të arkëtueshme është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet që pasqyron pasigurinë në lidhje me taksat e të ardhurave, nëse ka. Ajo matet duke përdorur tarifatat tatimore që janë në fuqi ose janë miratuar në parim duke filluar nga data e raportimit. Aktivitetet dhe detyrimet tatimore afatshkurtra netohen vetëm nëse plotësohen disa kritere.

*(ii) Tatimi i shtyrë*

Në vlerësimin e zhvlerësimit kolektiv Banka përdor modelimin statistikor të tendencave historike të probabilitetit të vonesës, koha e rikuperimit dhe shuma e humbjes së shkaktuar. Normat e parakohshme, normat e humbjeve dhe koha e pritshme për rikuperimet në të ardhmen krahasohen me rezultatet aktuale për të siguruar që ato mbeten të përshtatshme.

**6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(j) Instrumenti Financiar (vazhdim)**

**(xiii) Rimarja e zhvlerësimit**

Nëse, në një periudhë të mëpasshme, rritet vlera e drejtë e një borxhi të zhvlerësuar për shitje dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi, atëherë humbja nga zhvlerësimi është e anuluar nëpërmjet fitimit ose humbjes; përndryshe, çdo rritje në vlerën e drejtë njihet nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Çdo rikuperim i mëpasshëm i vlerës së drejtë të një aktivi financiar të zhvlerësuar me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse njihet gjithmonë në ATGj.

**(k) Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, referuar si kartëmonedha në pasqyrën e flukseve monetare përfshijnë kartëmonedhat dhe monedhat në dorë, balancat e pakufizuara që mbahen me bankat qendrore dhe shumë aktive financiare likuide me maturitet fillestar më pak se tre muaj, të cilat janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm të ndryshimit në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra të saj. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbarten me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

**(l) Huatë dhe paradhëniet**

"Huatë dhe paradhënie" në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë huatë dhe paradhëniet e matura me koston e amortizuar; ato maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit direkt në rritje, dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

**(m) Qira financiare**

Kur Banka është një qiradhënës në një qira e cila transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjithë rreziqet dhe përfitimet e rastësishme për pronësinë të qiramarrësi, aktivet e dhëna me qira paraqiten si një qira financiare e arkëtueshme dhe mbahen me vlerën aktuale të pagesave të qirasë në të ardhmen. Të arkëtueshmet e qirasë financiare njihen fillimisht në fillim (kur fillon afati i qirasë) duke përdorur një normë skontimi të përcaktuar në fillim (data e hershme e datës së marrëveshjes së qirasë dhe data e zotimit nga palët në dispozitat kryesore të qirasë).

Diferenca midis të zërave të arkëtueshëm bruto dhe vlerës aktuale paraqet të ardhura financiare të pafituara. Këto të ardhura njihen përgjatë kohëzgjatjes së qirasë duke përdorur metodën e investimit neto (përpara taksimit), e cila reflekton një kosto konstante kthimi duke zbatuar normën e nënkuptuar në qira në (i) vlerën bruto të qirasë financiare të arkëtueshme në fazën 1 dhe 2 dhe (ii) vlerën neto të qirasë financiare të arkëtueshme në fazën 3 të modelit HPK. Kostot rritëse të lidhura drejtpërdrejt me negocimin dhe rregullimin e qirasë përfshihen në matjen fillestare të qirasë financiare të arkëtueshme dhe zvogëlojnë shumën e të ardhurave të njohura gjatë afatit të qirasë. Të ardhurat financiare nga qiratë regjistrohen në të ardhura të tjera të ngjashme në fitim ose humbje.

Provizionet për humbjen e kredisë njihen në përputhje me modelin e përgjithshëm HPK, duke përdorur HPK përgjatë jetës. HPK përcaktohet në të njëjtën mënyrë si për huatë dhe paradhëniet e matura me koston e amortizuar dhe të njohura përmes një llogarie provizioni për të shkruar vlerën neto të arkëtueshme në vlerën aktuale të flukseve të pritshme të parave të zbritura me normat e interesit të nënkuptuara në qira financiare. Flukset e ardhshme të parave të gatshme pasqyrojnë flukset e parave që mund të rezultojnë nga marrja dhe shitja e aktiveve që i nënshtrohen qirasë.

**(n) Investime në letra me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**

Investimet në letra me vlerë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë instrumentat e borxhit të matura me Vlerën e Drejtë nëpërmjet të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse (VDATGj). Për instrumentat e borxhit të matura me VDATGj, fitimi ose humbja njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, përveç rasteve të mëposhtme të cilat njihen në fitim humbje me të njëjtën mënyrë sic njihen aktivet financiare të matura me metodën e koston të amortizuar:

- të ardhura nga interesi duke përdorur metodën e interesit efektiv;
- HPK dhe kthimet, dhe
- fitimet dhe humbjet e këmbimit valutor

Kur instrumentat e borxhit të matur me VDATGj janë çregjistruar, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në ATGj riklasifikohet nga kapitali neto në fitim ose humbje.

## OTP BANK ALBANIA SH.A.

### Shënime në pasqyrat financiare

(shuma në Lek '000, përveç rasteve kur thuhet ndryshe)

#### 6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

##### (o) Kolaterale të riposeduara

Inventari përfshin aktivet e riposeduara të blera nëpërmjet zbatimit të garancisë mbi kreditë me probleme dhe paradhëniet për klientët, të cilat nuk fitojnë qira dhe nuk përdoren nga Banka dhe janë të destinuara për nxjerrjen jashtë përdorimit në një periudhë mjaft të shkurtër kohe, pa ristrukturim. Aktivet e riposeduara maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme dhe çdo zhvlerësim njihet në fitim ose humbje.

##### (p) Aktive afatgjata materiale

###### (i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

###### (ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Bankë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në momentin kur ndodhin.

###### (ii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse me anën e metodës lineare gjatë jetës së çdo pjese të një aktivi afatgjat material. Përmirësimet e bëra në aktivet e marra me qira zhvlerësohen për kohën më të shkurtër të qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit.

Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si vijon:

	<u>(në vite)</u>
Ndërtesa	30
Kompjutera dhe pajisje informatike	5
Instalime dhe pajisje të tjera	5
Pajisje zyre	10
Automjete	5
Investime në mjetet e marra me qira	5

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit. Zhvlerësimi nuk llogaritet për aktivet në proces.

##### (q) Aktive afatgjata jomateriale

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëtejshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin. Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është dhjetë vjet.

##### (r) Borxhi i varur dhe fonde të tjera të huazuara

Borxhi i varur i emtuar njihet fillimisht në datën e tregtimit, d.m.th., datën në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Banka njihet detyrimet e obligacioneve të varura kur fondet i transferohen Bankës. Pas matjes fillestare, borxhi i varur i emtuar matet më pas me koston e amortizuar. Kostot e transaksionit njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Shpenzimet e interesit llogariten me normën nominale të interesit dhe njihen në fitim ose humbje kur llogariten. Interesi i përlllogaritur por i papaguar transferohet në llogarinë e të ardhurave dhe njihet si aktiv ose detyrim në llogarinë "interesi i përlllogaritur". Gjatë dhjetorit të këtij viti, Banka ka emtuar borxh të varur privat të pa listuar (referojuni Shënimit 23).

**6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(s) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare**

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse e monetare që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të mjeteve monetare skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur. Një humbje nga rënia në vlerë anulohet nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

**(t) Depozita dhe detyrime të tjera financiare**

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë pjesë e burimeve të financimit të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe hyn në një marrëveshje ri-blerjeje për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për riblerje në një datë të caktuar të ardhshme nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar pasi Banka ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Mjetet monetare përkatëse e pranuar njihet në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv me një detyrim korrespondues për ta kthyer atë, duke përfshirë interesin e përlllogaritur si një pasiv brenda kolateralit të parasë së gatshme në letrat me vlerë të huazuara dhe marrëveshjet e riblerjes duke pasqyruar thelbin ekonomik të transaksionit si një hua për Bankën. Diferenca midis çmimit të shitjes dhe të riblerjes trajtohet si shpenzim interesi dhe është përlllogaritur gjatë jetës së marrëveshjes duke përdorur normën e interesit efektiv.

Banka klasifikon instrumentat e borxhit si detyrime financiare ose instrumenta kapital në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

**(u) Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që një nxjerrje fondesh do të kërkohet për shlyerjen e këtij detyrimi.

Provizionet caktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para tatimit e cila reflekton vlerën e tregut dhe nëse është e përshtatshme rrezikun specifik të detyrimit.

**(v) Kapital aksionar**

Elementët e kapitalit janë kapitali aksionar, primi i aksioneve dhe rezervat. Kostot rritëse që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të aksioneve të reja trajtohen në kapital si zbritje, neto nga tatimi, nga të ardhurat. Cdo tepricë e drejtë të vlerës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si primi i aksioneve në kapitalin e vet.

## **6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **(w) Dividenti**

Dividentët regjistrohen në kapitalin neto në periudhën në të cilën ato janë deklaruar. Cdo dividend i deklaruar pas datës së raportimit dhe përpara autorizimit të pasqyrave financiare për publikim do të paraqitet në Shënimin për ngjarjet pas datës së raportimit. Raportet e kontabilitetit SNRF të bankës janë baza për shpërndarjen e fitimit dhe ndarjeve të tjera.

### **(x) Garancitë financiare dhe angazhimet e huasë**

Në rrjedhën normale të biznesit, Banka lëshon garanci financiare, të përbërë nga letër kredi, garanci dhe pranimet. Garancitë financiare fillimisht njihen në pasqyrat financiare (brenda 'detyrimeve të tjera') me vlerën e drejtë, që është primi i marrë. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Bankës nën çdo garanci është matur me më të lartën midis shumës fillestare të njohur minus amortizimin e akumuluar të njohur në fitim humbje, dhe vlerësimit më të mirë të shpenzimeve të kërkuara për të shlyer çdo detyrim financiar që lind si rezultat i garancisë. Çdo rritje e detyrimit që lidhet me garancitë financiare regjistrohet në pasqyrën e fitim humbjes në shpenzimet e humbjeve kreditore. Primi i pranuar njihet në pasqyrën e fitim humbjes në të ardhurat neto të komisioneve në mënyrë lineare gjatë jetës së garancisë. Më pas, garancitë financiare maten me vlerën më të madhe të fondit për humbjet nga zhvlerësimet e përcaktuar sipas SNRF 9 dhe shuma e njohur në fillim minus, sipas rastit, shumën e akumuluar të të ardhurave të njohura në përputhe me parimet e SNRF 15.

Angazhimet e huasë maten më pas neto nga zbritja për humbje kreditore e njohur në përputhje me SNRF 9.

## **7. Standartet e nxjerra por ende jo efektive**

Banka nuk ka miratuar më herët ndonjë standart të ri, interpretim apo amendim që është nxjerrë por nuk është ende efektiv në këto pasqyra financiare. Amendimet e mëposhtme janë efektive për periudhat pas datës 31 dhjetor 2023 dhe nuk pritet të kenë një ndikim material në Bankë.

- **SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare: Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtër ose afatgjatë (Amendim).** Amendimet janë efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024, me aplikim më të hershëm të lejuar dhe do të duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8. Objektivi i amendimeve është të qartësojë parimet në SNK 1 për klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata. Amendime sqarojnë kuptimin e një të drejte për të shtyrë shlyerjen, kërkesën që kjo e drejtë të ekzistojë në fund të periudhës raportuese, që qëllimi i menaxhimit të mos ndikojë në klasifikimin afatshkurtër ose afatgjatë, se opsionet nga pala tjetër që mund të rezultojnë në shlyerje nga transferimi i instrumenteve të kapitalit të vet të njësisë ekonomike nuk ndikojnë në klasifikimin afatshkurër ose afatgjatë. Gjithashtu, amendimet specifikojnë se vetëm marrëveshjet me të cilat një njësi ekonomike duhet të pajtohet në ose përpara datës së raportimit do të ndikojnë në klasifikimin e një pasivi. Dhënie informacionesh shpjeguese shtesë kërkohe gjithashtu për detyrimet afatgjata që rrjedhin nga marrëveshjet e huasë që i nënshtrohen marrëveshjeve që duhet të respektohen brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit.
- **SNRF 16 Qiratë: Detyrimi i qirasë në një shitje dhe kthim me qira (Amendim)** Amendimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024, me aplikim të mëhershëm të lejuar. Amendimet synojnë të përmirësojnë kërkesat që përdor një shitës-qiramarrës në matjen e detyrimit të qirasë që lind nga një transaksion shitje dhe kthimi me qira në SNRF 16, ndërkohë që nuk ndryshon kontabilitetin për qiratë që nuk lidhen me transaksionet e shitjes dhe të kthimit me qira. Në veçanti, shitësi-qiramarrësi përcakton "pagesat e qirasë" ose "pagesat e qirasë të rishikuara" në mënyrë të tillë që shitësi-qiramarrësi të mos njohë asnjë shumë të fitimit ose humbjes që lidhet me të drejtën e përdorimit që ruan. Zbatimi i këtyre kërkesave nuk e pengon shitësin-qiramarrësin të njohë, në fitim ose humbje, çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë. Një shitës-qiramarrës e zbaton ndryshimin në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 për transaksionet e shitjes dhe kthimit me qira të kryera pas datës së aplikimit fillestar, duke qenë fillimi i periudhës së raportimit vjetor në të cilën një njësi ekonomike zbatoi për herë të parë SNRF 16.
- **SNK 7 Pasqyra e flukseve monetare dhe SNRF 7 Shpalosja e Instrumenteve Financiare - Marrëveshjet Financiare të Furnizuesit (Amendime).** Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024, me aplikim të mëhershëm të lejuar. Ndryshimet plotësojnë kërkesat tashmë në SNRF dhe kërkojnë që një njësi ekonomike të japë informacion shpjegues për termat dhe kushtet e marrëveshjeve financiare të furnitorëve.

## **7. Standartet e nxjerra por ende jo efektive (vazhdim)**

- **SNK 7 Pasqyra e flukseve monetare dhe SNRF 7 Dhënia e informacioneve shpjeguese të instrumenteve financiare - Marrëveshjet financiare të furnizuesit (Amendimet) (vazhdim).** Për më tepër, njësitë ekonomike u kërkohet të japin informacion shpjegues në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit vlerat kontabël të detyrimeve financiare të marrëveshjeve financiare të furnizuesit dhe zërat në të cilët paraqiten këto detyrime, si dhe vlerat kontabël të detyrimeve financiare dhe zërat e linjës, për të cilat ofruesit e financave kanë shlyer tashmë të pagueshmet tregtare përkatëse. Njësitë ekonomike duhet të japin informacion shpjegues për llojin dhe efektin e ndryshimeve jo-monetare në vlerat kontabël të detyrimeve financiare të marrëveshjeve financiare të furnizuesit, të cilat parandalojnë që vlerat kontabël të detyrimeve financiare të jenë të krahasueshme. Për më tepër, ndryshimet kërkojnë që një njësi ekonomike të japë informacion shpjegues në fillim dhe në fund të periudhës raportuese gamën e datave të pagesës për detyrimet financiare që u detyrohen ofruesve të financave dhe për të pagueshmet tregtare të krahasueshme që nuk janë pjesë e këtyre marrëveshjeve. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE.
- **SNK 21 Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor: Mungesa e këmbyeshmërisë (Amendime).** Amendimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2025, me aplikim të mëhershëm të lejuar. Amendimet përcaktojnë se si një njësi ekonomike duhet të vlerësojë nëse një monedhë është e këmbyeshme dhe si duhet të përcaktojë një kurs këmbimi në moment kur këmbyeshmëria mungon. Një monedhë konsiderohet e këmbyeshme në një monedhë tjetër kur një njësi ekonomike është në gjendje të marrë monedhën tjetër brenda një periudhe kohore që lejon një vonesë normale administrative dhe nëpërmjet një tregu ose mekanizmi këmbimi në të cilin një transaksion këmbimi do të krijonte të drejta dhe detyrime të zbatueshme. Nëse një monedhë nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë kursin e këmbimit në datën e matjes. Objektivi i një njësie ekonomike në vlerësimin e kursit të këmbimit spot është të pasqyrojë kursin me të cilin do të ndodhte një transaksion i rregullt këmbimi në datën e matjes midis pjesëmarrësve të tregut në kushtet ekonomike mbizotëruese. Ndryshimet vënë re se një njësi ekonomike mund të përdorë një kurs këmbimi të vëzhgueshëm pa rregullim ose një teknikë tjetër vlerësimi. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE.
- **Amendime në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta: Shitja ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët.** Ndryshimet trajtojnë një mospërputhje të pranuar midis kërkesave në SNRF 10 dhe atyre në SNK 28, në trajtimin e shitjes ose kontributit të aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët. Pasoja kryesore e ndryshimeve është se një fitim ose humbje e plotë njihet kur një transaksion përfshin një biznes (nëse ai është i vendosur në një filial ose jo). Një fitim ose humbje e pjesshme njihet kur një transaksion përfshin aktive që nuk përbëjnë një biznes, edhe nëse këto aktive janë të vendosura në një filial. Në dhjetor 2015, BSNK shtyu datën e hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi për një kohë të pacaktuar në pritje të rezultatit të projektit të saj kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të kontabilitetit. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE.

## **8. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël**

Drejtimi diskuton me Bordin e Drejtorëve zhvillimin, përzgjedhjen dhe shpalosjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të Bankës, si dhe zbatimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet në vlerësimet e kontabilitetit njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse rishikimi prek vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhave të ardhshme, nëse rishikimi prek si periudhat aktuale ashtu edhe ato të ardhshme. Këto informacione shpjeguese plotësojnë komentimin mbi menaxhimin e rrezikut financiar (shiko shënimin 41).

### **A. Gjykime**

Informacioni në lidhje me gjykimet e bëra gjatë zbatimit të politikave kontabël që kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshihen në shënimet e mëposhtme.

- Shënimi 41(b)(vi): përcaktimi i kritereve për vendosjen nëse rreziku i kredisë për aktivin financiar është rritur në mënyrë të konsiderueshme që nga njohja fillestare, duke përcaktuar metodologjinë për përfshirjen e informacionit të ardhshëm në matjen e HPK, zgjedhjen dhe miratimin e modeleve të përdorura për të matur HPK.

- Shënimi 6 (k) (ii): klasifikimi i aktiveve financiare: vlerësimi i modelit të biznesit brenda të cilit janë mbajtur aktivet dhe vlerësimi nëse kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar janë VPPI në shumën kryesore të papaguar.

- Shënimet 6 (x)(yy): vazhdimësia: nëse ka pasiguri materiale që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar si vijimësi.



## **8. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **B. Burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit**

#### **(a) Zhvlerësimi nga humbjet e aktiveve financiare**

Matja e humbjeve nga zhvlerësimi sipas SNRF 9 në të gjitha kategoritë e aktiveve financiare në objekt kërkon gjykim, në veçanti, vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve monetare të ardhshme dhe vlerave të kolateralit kur përcaktohen humbjet nga rënia në vlerë dhe vlerësimi i një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë. Këto vlerësime nxiten nga një sërë faktorësh, ndryshimet në të cilët mund të rezultojnë në nivele të ndryshme të lejimeve.

Matja e HPK-ve është një vlerësim i rëndësishëm që përfshin përcaktimin e metodologjisë, modeleve dhe hyrjeve të të dhënave. Detajet e metodologjisë së matjes HPK janë shpalosur më poshtë:

Komponentët e mëposhtëm kanë një ndikim të madh në zbritjet nga humbjet e kredisë:

- segmentimi i aseteve financiare për qëllimet e vlerësimit të humbjeve të pritshme kreditore (HPK);
- përcaktimi i një niveli të vlerësimit të HPK mbi një bazë individuale të instrumentit ose mbi një bazë kolektive;
- përcaktimi i mospagimit të aplikuar nga Banka;
- zhvillimi dhe zbatimi i modeleve të klasifikimit të brendshëm të kredisë, i cili cakton probabilitetin e dështimit (PD-të) për shkallët individuale të rrezikut të kredisë;
- zhvillimi dhe zbatimi i modeleve të brendshme të përdorura për të vlerësuar ekspozimin në rast dështimi ("ED") për instrumentet financiare dhe zotimet e lidhura me kredinë;
- vlerësimi i humbjes në rast dështimi ("HD"), duke përfshirë gjykimet për vlerësimin e kolateralit; - kriteret për vlerësimin nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë;
- zgjedhja e skenarëve makroekonomikë të ardhshëm dhe peshat e tyre të probabilitetit.

Banka rregullisht rishikon dhe vërteton modelet dhe inputet në modele për të zvogëluar çdo ndryshim midis vlerësimeve të pritshme të humbjes së kredisë dhe përvojës aktuale të humbjes së kredisë.

OTP HQ ofron një sërë parametrash rreziku për grupin për llogaritjet kolektive të provizioneve. Gjatë vitit 2023 u kryen 3 runde rishikimi të parametrave nga selia e OTP dhe u zbatuan nga Banka si më poshtë:

- T2 2023: rishikim tremujor i parashikimeve makro, duke përdorur trajektoret e PBB-së të përgatitura nga Qendra Kërkimore e OTP HQ me peshat e skenarëve të pandryshuara, gjë që rezultoi në zhvlerësim prej 260.13 milionë lekë.
- T3 2023: rishikim vjetor i parametrave PD dhe HD, i cili rezultoi në një rritje të ndjeshme të provizioneve prej 495.5 milionë lekësh për shkak të normave të larta të mospagesës dhe mungesës së periudhave të vëzhgimit të portofolit ish ABA. Gjithashtu, formula e HD u rishikua duke përfshirë edhe të dhënat e kolateralit, të marra në konsideratë vetëm nëse një ekspozim është Hipotekë/MSE/MLE dhe lloji kryesor i kolateralit janë pasuritë e paluajtshme rezidenciale ose komerciale, me një ndikim çlirim prej 64.3 milionë lekë. Në përgjithësi, ndikimi i rishikimit të parametrave në tremujorin e tretë 2023 ishte një rritje prej 431.17 milionë lekë.
- T4 2023: rishikim i pritshmërive (skenarëve) të ardhme me parametra të pandryshuar HD dhe peshat e skenarëve, të cilat rezultuan në lirim nga zhvlerësimi prej 208.15 milionë lekë.

#### **(b) Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë ("RRNRRK")**

Në mënyrë që të përcaktohet nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë, Banka krahason rrezikun e një mospagimi që ndodh gjatë jetës së një instrumenti financiar në fund të datës së raportimit me rrezikun e mospagimit në datën e njohjes fillestare. Vlerësimi konsideron rritjen relative të rrezikut të kredisë sesa arritjen e një niveli specifik të rrezikut të kredisë në fund të periudhës raportuese.

Banka i konsideron të gjitha informacionet e arsyeshme dhe të mbështetshme të disponueshme pa kosto dhe përpjekje të panevojshme, të cilat përfshijnë një sërë faktorësh, përfshirë aspektet e sjelljes të portofoleve të veçantë të klientëve. Banka identifikon treguesit e sjelljes të rritjes së rrezikut të kredisë para delikuencës dhe përfshiu informacionin e duhur në vlerësimin e rrezikut të kredisë, ose në një instrument individual, ose në një nivel portofoli.

**(c) Vlerësimi i modelit të biznesit.** Banka klasifikon të gjitha aktivet e saj financiare bazuar në modelin e biznesit për administrimin e aktiveve dhe kushtet kontraktuale të aktiveve të matura në:

- Kosto e amortizuar
- VDATGj

## **8. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **B. Burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit (vazhdim)**

#### ***(c) Vlerësimi i modelit të biznesit (vazhdim)***

Banka konsideron strategjinë e saj për 2023-2025 për rritjen e huave për klientët, ndërsa ndërton në të njëjtën kohë një bazë të përshtatshme depozitash nga klientët. Prandaj, investimet në letra me vlerë shihet t'i shërbejnë nevojave të likuiditetit dhe një pjesë e këtij portofoli pritet të shitet për të mbuluar nevojën e fondeve në aktivitetin e huave të klientëve.

Para se të përdoren për të zgjeruar aktivitetin e huasë, këto letra me vlerë mund të përdoren si kolateral në transaksionet e Repos me Bankën Qëndrore të Shqipërisë dhe i gjithë portofoli i letrave me vlerë është pjesë e mbrojtjes të likuiditetit të nevojshëm në vend dhe për "Raportin e Mbulimit të Likuiditetit Raportet e likuiditetit Basel III". Kjo është në përputhje me strategjinë e Grupit ALM sepse sipas konceptit të likuiditetit operativ të nivelit të Grupit, letrat me vlerë që janë të pranueshme për transaksione repo me bankën qendrore, duhet të jenë pjesë e portofolit të aktiveve likuide dhe ato mund të përdoren si mbulim i daljeve kontraktuale të parave dhe goditjet potenciale të likuiditetit

Sipas politikës ALM të Grupit OTP, shitja e aktiveve është pjesë e drejtpërdrejtë e menaxhimit të likuiditetit, duke përfshirë aktivet nga likuiditeti dytësor ose aktivet jolikuide. Prandaj, Banka dhe Grupi OTP beson se modeli i biznesit të portofolit të letrave me vlerë është në përputhje me parimet e SNRF 9 "Mbjaj për të mbledhur dhe shitur" dhe kështu ato maten me "Vlera e drejtë përmes ATGj".

Pas bashkimit ligjor me Alpha Bank, banka ka përfshirë në model biznesi obligacione, objektivi i të cilave është mbajtja e instrumenteve financiare për të mbledhur flukset e tyre kontraktuale të parasë (të mbajtura deri në maturim).

#### ***(d) Modifikimi i aktiveve financiare***

Kur aktivet financiare modifikohen me kontratë (p.sh. rinegociohen), Banka vlerëson nëse modifikimi është thelbësor dhe duhet të rezultojë në mosnjohje të aktivitetit origjinal dhe njohje të një aktiviteti të ri me vlerën e drejtë. Ky vlerësim bazohet kryesisht në faktorë cilësorë, të përshkruar në politikën përkatëse të kontabilitetit dhe kërkon gjykim të rëndësishëm. Në veçanti, Banka zbaton gjykimin për të vendosur nëse huatë e rinegociuara të dëmtuara nga kredia duhet të çregjistrohen dhe nëse huatë e reja të njohura duhet të konsiderohen si të zhvlerësuara që në njohjen fillestare. Vlerësimi i mosnjohjes varet nëse rreziqet dhe përfitimet, domethënë, ndryshueshmëria e flukseve të parave të pritura (në vend se kontraktuale), ndryshojnë si rezultat i modifikimeve të tilla. Drejtimi i Bankës përcaktoi që rreziqet dhe përfitimet nuk ndryshuan si rezultat i modifikimit të kredive të tilla dhe për këtë arsye në të gjitha modifikimet e tilla, kreditë nuk u çregjistruan dhe as nuk u klasifikuan jashtë fazës së zhvlerësimit të kredisë.

#### ***(e) Vlera e drejtë e instrumentave financiarë***

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare është çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt në tregun kryesor (ose më të favorshëm) në datën e matjes në kushtet aktuale të tregut (d.m.th., një çmim dalje) pavarësisht nëse ky çmim është drejtpërdrejt i vëzhgueshëm ose i vlerësueshëm duke përdorur një teknikë tjetër të vlerësimit. Kur vlerat e drejta të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të derivojnë nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një larmi teknikash vlerësimi që përfshijnë përdorimin e modeleve të vlerësimit. Inputet në këto modele merren nga tregjet e vëzhguara kur është e mundur, por kur kjo nuk është e mundur, kërkojnë matje dhe vlerësime në përcaktimin e vlerave të drejta. Gjykimet dhe vlerësimet përfshijnë konsideratat e likuiditetit dhe të inputeve të modelit që lidhen me zëra të tillë si rreziku i kredisë (si i vetes ashtu dhe i palës tjetër), normat e përditësuara të interesit nga tregu, korrelacioni dhe paqëndrueshmëria. Për më shumë detaje rreth përcaktimit të vlerës së drejtë, ju lutemi shikoni Shënimin 6(j) (xi) dhe 41 (e) i).

#### ***(f) Përcaktimi i afatit të qirasë për kontratat e qirasë me opsione rinovimi dhe përfundimi (Banka si qiramarrëse)***

Banka e përcakton afatin e qirasë si afat të paanullueshëm të qirasë, së bashku me çdo periudhë të mbuluar nga një opsion për të zgatur qiranë nëse është e sigurt në mënyrë të arsyeshme se do të ushtrohet, ose çdo periudhë të mbuluar nga një opsion për të përfunduar qiranë, nëse është në mënyrë të arsyeshme e sigurt që nuk do të ushtrohet.

**8. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**B. Burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit (vazhdim)**

***(f) Përcaktimi i afatit të qirasë për kontratat e qirasë me opsione rinovimi dhe përfundimi (Banka si qiramarrëse) (vazhdim)***

Banka ka disa kontrata qiraje që përfshijnë opsione zgjatjeje dhe përfundimi. Banka zbaton gjykimin në vlerësimin nëse është në mënyrë të arsyeshme e sigurt nëse do të ushtrojë apo jo opsionin për të rinovuar ose përfunduar qiranë. Kjo do të thotë, ai merr në konsideratë të gjithë faktorët përkatës që krijojnë një nxitje ekonomike për të për të ushtuar ose rinovimin ose përfundimin. Pas datës së fillimit, Banka rivlerëson afatin e qirasë nëse ka një ngjarje të rëndësishme ose ndryshim në rrethana që është nën kontrollin e saj që ndikon në aftësinë e saj për të ushtuar ose jo për të ushtuar opsionin për të rinovuar ose për të përfunduar (p.sh., ndërtimi i një qiraje të rëndësishme përmirësime ose përshtatje të konsiderueshme të aktivitetit të dhënë me qira).

***(g) Vlerësimi i normës në rritje të huamarrjes***

Banka nuk mund të përcaktojë lehtësisht normën e interesit të nënkuptuar në qira, prandaj, ajo përdor normën e saj rritëse të huamarrjes (IBR) për të matur detyrimet e qirasë. IBR është norma e interesit që Banka duhet të paguajë për të marrë hua për një afat të ngjashëm, dhe me një garanci të ngjashme, fondet e nevojshme për të marrë një aktiv me vlerë të ngjashme me aktivin e të drejtës së përdorimit në një mjedis të ngjashëm ekonomik. Prandaj, IBR pasqyron atë që Banka 'do të duhet të paguajë', e cila kërkon vlerësim kur nuk ka tarifa të vëzhgueshme (si p.sh. për filialet që nuk hyjnë në transaksione financimi) ose kur ato duhet të rregullohen për të pasqyruar termat dhe kushtet e qirasë (për shembull, kur qiratë nuk janë në monedhën funksionale të filialit).

Norma e skontimit e aplikuar për llogaritjen e vlerës aktuale - përveç rasteve kur kontrata ka dispozita të tjera - është norma rritëse e huamarrjes e përcaktuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Aseteve dhe Detyrimeve të Bankës në baza mujore për çdo vend, për monedhë për 1, 3, 5, 7, terma 10 vjeçarë bazuar në kurbat e normës së interesit të kuponit zero të letrave me vlerë të qeverisë u rritën nga diferenca që reflekton rrezikun e Grupit.

***(h) Ekspozimet tatimore***

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse mund të paguhen taksa dhe interesa shtesë. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Mund të bëhet i disponueshëm informacioni i ri që shkakton Bankën të ndryshojë gjykimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën kur bëhet një përcaktim i tillë. (Shënim 36).

***(i) Aktivitetet tatimore të shtyra***

Aktivitetet tatimore të shtyra njihen në lidhje me diferencat e përkohshme në masën që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit mund të përdoren humbjet. Kërkohet një gjykim për të përcaktuar shumën e aktiveve tatimore të shtyra që mund të njihen, bazuar në kohën e mundshme dhe nivelin e fitimeve të tatueshme në të ardhmen, së bashku me strategjitë e ardhshme të planifikimit tatimor (Shënim 25).

***(j) Provizionet dhe detyrimet e tjera kontigjente***

Drejtimi i Bankës ka krijuar një proces të brendshëm në lidhje me njohjen dhe matjen e provizioneve dhe kontingjenteve për shkak të çështjeve gjyqësore aktuale ose kërcënuese. Supozimet kryesore rreth mundësisë dhe madhësisë së një daljeje burimesh bazohen në këshillat ligjore të brendshme dhe të jashtme që ndjekin strategjitë përkatëse të suksesshme të mbrojtjes kundër veprimeve që rezultojnë. Çdo veprim dhe rrezik përkatës vlerësohen në bazë të meritave të tij dhe detyrimit themelor konstruktiv ose ligjor dhe vlerësimit të daljeve monetare të konsideruara të pagueshme. Drejtimi beson se proceset gjyqësore ekzistuese ose të mundshme në të ardhmen janë të largëta, megjithatë për shkaqe përtej sfondit ligjor dhe kornizës mund të shkaktohen rreziqe të mëtejshme (Shënim 6 (t), Shënim 24, Shënim 37).

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Shënime në pasqyrat financiare***(shuma në Lek'000, përveç rasteve kur thuhet ndryshe)***8. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)****8.1 Bashkimi me perthithje Alpha Bank Albania në OTP Bank Albania**

Siç shpjegohet në shënimin 1 të pasqyrës financiare më 1 dhjetor 2022, Banka u bashkua me Alpha Bank Albania. OTP Bank Nyrt (Hungari) zotëronte plotësisht të dyja bankat dhe kontrolli nuk ndryshoi pas bashkimit. OTP Hungari ende kontrollon plotësisht subjektin e bashkuar, ku OTP Bank Albania është subjekti i mbijetuar. Transaksioni përfaqësonte një kombinim biznesi që përfshin njësitë ekonomike nën kontroll të përbashkët dhe si i tillë ai ishte i përjashtuar nga trajtimi kontabël i përshkruar në SNRF 3 Kombinimi i Biznesit. Metoda e bashkimit të interesit është e përshtatshme për të llogaritur bashkimin midis dy filialeve motra dhe drejtimi ka zgjedhur të përdorë vlerat kontabël të pasqyrave financiare individuale të Alpha Bank Albania për bashkimin.

Vlerat kontabël në një bashkim me kompaninë motër konsiderohen të jenë më të rëndësishme për përdoruesit e pasqyrave financiare individuale statutoresë sesa vlerat e përdorura në blerjen e ABA nga OTP Group, sepse shumat kontraktuale janë më të rëndësishme nga këndvështrimi rregullator dhe të klientëve, të cilët janë ndër përdoruesit kryesorë të jashtëm të pasqyrave financiare. Gjithashtu, ka pasur grup të konsoliduar para ose pas bashkimit në nivel lokal dhe vlerat e drejta me marrjen fillestare të kontrollit nga OTP Group përdoren vetëm në nivelin përfundimtar të konsolidimit.

Aktivitetet dhe detyrimet e Alpha Bank Albania janë bashkuar me Bankën bazuar në vlerat kontabël të datës 1 dhjetor 2022. Diferenca midis aktiveve dhe detyrimeve neto të transferuara nëpërmjet bashkimit njihet në kapital si rezervë nga bashkimi me perthithje.

Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve të identifikuar të Alpha Bank Albania në datën e bashkimit me perthithje janë paraqitur si më poshtë:

	<b>Vlera e mbartur bruto</b>	<b>Provizione /Zhvlerësime</b>	<b>Vlera mbartur neto</b>
<b>Aktivitetet</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre (Shënim 9)	4,408,467	-	4,408,467
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore Huatë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare (41 (b) (i))	6,909,252	-	6,909,252
Instrumentet e borxhit në VDATGj (41 (b) (i))	13,490,757	-	13,490,757
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	10,613,767	-	10,613,767
Hua dhe parapagime për klientët, neto (Shënimi 13)	3,180,587	(21,451)	3,159,136
Aktive të tjera (Shënimi 14)	30,662,439	(2,875,597)	27,786,842
Aktive afatgjata materiale (Shënimi 15)	467,324	-	467,324
Aktive me të drejtë përdorimi (Shënimi 16)	2,096,123	(1,704,721)	391,402
Aktive afatgjata jomateriale (Shënimi 17)	1,549,372	(692,294)	857,078
Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore (Shënimi 18)	749,105	(516,582)	232,523
Aktive tatimore të shtyra, neto (Shënimi 25)	355,975	(178,033)	177,942
	70,733	-	70,733
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>74,553,901</b>	<b>(5,988,678)</b>	<b>68,565,223</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj institucioneve financiare dhe bankae	2,500	-	2,500
Detyrime ndaj klientëve	61,844,241	-	61,844,241
Detyrime ndaj qirasë (Shënimi 21)	923,205	-	923,205
Detyrime të tjera	515,382	-	515,382
Provizionet për detyrimet dhe tarifatat (Shënimi 24)	522,322	-	522,322
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>63,807,650</b>	<b>-</b>	<b>63,807,650</b>
<b>Mjetet neto të përfituara - Rezerva e bashkimit</b>			<b>4,757,573</b>
<b>Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara</b>	<b>1,159,400</b>	<b>(20,648)</b>	<b>1,138,752</b>

Asnjë kombinim biznesi nuk ka ndodhur gjatë vitit 2023.

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Shënime në pasqyrat financiare***(shuma në Lek'000, përveç rasteve kur thuhet ndryshe)***9. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor 2023 and 31 dhjetor 2022 janë të detajuar si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Arka		
Në Lek	1,540,058	972,336
Në monedhë të huaj	1,544,569	1,771,670
Llogari rrjedhëse me Bankën Qëndrore	11,019,897	7,340,601
Llogari rrjedhëse me bankat e tjera	2,296,645	2,494,631
Depozita me bankat dhe institucionet financiare	4,164,816	5,252,542
Humbje të pritshme (Shënimi 41b) (ii))	(18,787)	(51,784)
<b>Total</b>	<b>20,547,198</b>	<b>17,779,996</b>

Humbjet e pritshme më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, janë detajuar si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
<b>Humbje të pritshme</b>		
Llogari rrjedhëse me Bankën Qëndrore	3,399	6,354
Llogari rrjedhëse me bankat e tjera	4,323	11,546
Depozita me bankat dhe institucionet financiare	11,065	33,884
<b>Totali</b>	<b>18,787</b>	<b>51,784</b>

Norma e interesit vjetor për depozitat me afat me bankat rezidente gjatë vitit 2023 variojnë nga 1,75% deri në 5% (2022: 0.10% deri në 2.84%) dhe për depozitat me afat me bankat jo-rezidente nga 1.05% deri në 6.37% (2022: -0.42% deri në 4.79%). Llogaritë rrjedhëse me bankat në 31 dhjetor 2023 dhe 2022 janë të detajuara gjeografikisht si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Hungari	103,402	603,838
Britani e Madhe	1,437,452	442,006
Francë	637,331	1,104,298
Greqi	112,938	96,727
Zvicër	5,522	96,364
Austri	-	126,316
Shqipëri	-	25,082
<b>Totali</b>	<b>2,296,645</b>	<b>2,494,631</b>
Humbje e pritshme (Note 41 b) (ii))	(4,323)	(11,546)
<b>Shuma totale neto pas zhvlerësimit</b>	<b>2,292,322</b>	<b>2,483,085</b>

Depozita me bankat dhe institucionet financiare në 31 dhjetor 2023 dhe 2022 janë të detajuara gjeografikisht si më poshtë dhe maturiteti i tyre varion nga 5-8 ditë:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Shqipëri	1,974,031	3,065,436
Itali	2,190,785	2,187,106
<b>Totali</b>	<b>4,164,816</b>	<b>5,252,542</b>
Humbje e pritshme (Note 41 b) (ii))	(11,066)	(33,884)
<b>Shuma totale neto pas zhvlerësimit</b>	<b>4,153,750</b>	<b>5,218,658</b>

## OTP BANK ALBANIA SH.A.

### Shënime në pasqyrat financiare

(shuma në Lek'000, përveç rasteve kur thuhet ndryshe)

#### 10. Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore

Në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë në lidhje me rezervën e detyrueshme të depozitave, Banka duhet të mbajë në rezervë të detyrueshme pranë Bankës së Shqipërisë një balancë të kufizuar. Rezerva e detyrueshme nuk është e disponueshme për përdorim operacional në bazë ditore, megjithatë sipas rregullores së aplikuar Banka mund të përdorë deri në 70% (2022: 70%) të rezervës së detyruar në LEK, duke parashikuar që mesatarisht balanca e rezervës në ditën e fundit të periudhës nuk bie nën nivelin e kërkuar.

Rezerva e detyrueshme me Bankën Qëndrore është detajuar si më poshtë për 31 dhjetor 2023 dhe 2022:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Rezerva e detyrueshme	14,215,005	14,958,438
Interesat e përllogaritur	1,964	1,197
Humbjet e pritshme	(3,150)	(5,408)
<b>Totali</b>	<b><u>14,213,819</u></b>	<b><u>14,954,227</u></b>

Normat e rezervës ndryshojnë në varësi të maturitetit të depozitës dhe të monedhës. Normat e detajuara janë si më poshtë :

- 7.5% për depozitat e klientëve në LEK me maturitet deri në 12 muaj.
- 5.0% për depozitat e klientëve në LEK me maturitet mbi 12 muaj deri në 2 vite.
- 12.5% për depozitat e klientëve, kur normat e “depozitave të klientëve denominohen në monedhë të huaj përmbi totalin e depozitave të klientit” janë deri në 50%.
- 20% për depozitat e klientëve, kur normat e “depozitave të klientëve denominohen në monedhë të huaj përmbi totalin e depozitave të klientit” janë mbi 50%.

#### 11. Huatë dhe parapagime ndaj institucioneve financiare

Huatë dhe parapagimet ndaj institucioneve financiare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 janë të detajuara si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Rezidentë		
- Hua ndaj institucioneve financiare	873,646	628,304
Jo rezidentë		
- Llogari <i>escrow</i> për garanci bankare	33,032	11,423
Humbjet e pritshme të kredisë	(12,648)	(11,975)
<b>Totali</b>	<b><u>894,030</u></b>	<b><u>627,752</u></b>

Informacioni në lidhje me HPK është paraqitur në Shënimin 41 b) (i) *Huatë dhe paradhëniet për institucionet financiare*.

#### 12. Investime në letrat me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Letrat me vlerë me VDATGj më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Obligacione qeveritare	25,838,655	29,907,317
Obligacione korporative	1,874,622	2,637,864
<b>Totali</b>	<b><u>27,713,277</u></b>	<b><u>32,545,181</u></b>

Interesi i obligacioneve të qeverisë merret çdo gjashtë muaj me një normë kuponit më 31 dhjetor 2023 që varion nga 2.2% to 9.25% (31 Dhjetor 2022: nga 0.88% në 9.25%). Banka nuk kishte asnjë instrument borxhi të matur në VDATGj të cilat ishin lënë peng si kolateral deri më 31 dhjetor 2023 (2022: zero).

Banka ka shitur VDATGj përgjatë 2023 me një humbje neto në 38,152 mijë lekë (2022:zero).

Informacioni në lidhje me lejimin HPK për instrumentet e borxhit të matur me VDATGj është paraqitur në Shënimin 41 b) (ii) *Instrumentet e borxhit të matur me VDATGj*.

Më shumë informacion në lidhje me metodologjitë e vlerësimit gjenden në Shënimin 6(j) (xi).

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Shënime në pasqyrat financiare***(shuma në Lek'000, përveç rasteve kur thuhet ndryshe)***12. Investime në letrat me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj) (vazhdim)****12.1 Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar**

Letrat me vlerë me kosto amortizimi më 31 dhjetor 2023 and 2022 janë detajuar si më poshtë:

31 dhjetor 2023	Vlera	Prim	Interesi i	HPK	Vlera e mbartur
	Nominale	/(skonto)e pa amortizuar	perllogaritur		
Obligacione Korporative	779,100	6,884	3,282	(5,838)	783,427
Bonot e Qeverisë Shqiptare	7,796,100	42,329	132,009	(21,732)	7,948,705
Bonot e thesarit	1,781,480	(58,668)	34,069	(4,790)	1,752,091
<b>Total</b>	<b>10,356,680</b>	<b>(9,456)</b>	<b>169,360</b>	<b>(32,360)</b>	<b>10,484,224</b>

  

31 dhjetor 2022	Vlera	Prim	Interesi i	HPK	Vlera e mbartur
	Nominale	/(skonto)e pa amortizuar	përlllogaritur		
Obligacione Korporative	856,725	12,691	3,614	(7,208)	865,822
Bonot e Qeverisë Shqiptare	900,000	(23,334)	10,290	(4,152)	882,804
Bonot e thesarit	1,450,000	(56,290)	15,619	(6,597)	1,402,732
<b>Total</b>	<b>3,206,725</b>	<b>(66,933)</b>	<b>29,523</b>	<b>(17,957)</b>	<b>3,151,358</b>

**13. Hua dhe paradhënie për klientët, neto**

Huatë dhe paradhëniet neto dhënë klientëve në 31 dhjetor 2023 dhe 2022 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Sipërmarrës privat dhe ndërmarrje	48,849,045	53,984,729
Individë	17,995,907	22,031,514
Kredi hipotekore	32,679,141	30,223,094
<b>Totali bruto</b>	<b>99,524,093</b>	<b>106,239,337</b>
Minus zhvlerësimin	(6,110,481)	(6,314,326)
<b>Totali</b>	<b>93,413,612</b>	<b>99,925,011</b>

  

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Kreditë me këste	78,934,036	82,070,782
Paradhëniet	20,345,099	23,872,878
Karta krediti	244,958	295,677
<b>Totali i kredive dhe paradhënieve bruto</b>	<b>99,524,093</b>	<b>106,239,337</b>

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2023, Bank ka fshirë nga librat huatë me vlerë 59,281 mijë lekë (2022: huatë të fshira në 133,509 mijë lekë).

Huatë sipas llojit të klientit dhe produktit janë paraqitur në shënimin 41 b) (iii) *Huatë dhe paradhëniet për klientët*. Legjislacioni i humbjes së kredisë për huatë dhe paradhëniet për klientët e njohur në periudhë ndikohet nga një sërë faktorësh, detajet e matjes së HPK-së jepen në Shënimin 6 (j).

Lëvizjet kryesore në tabelë janë përshkruar më poshtë:

- Transfertat ndërmjet Fazave 1, 2 dhe 3 për shkak të gjendjeve që përjetojnë rritje (ose ulje) të konsiderueshme të rrezikut të kredisë ose që zhvlerësohen nga kredia gjatë periudhës, dhe si pasojë e "rritjes" (ose "uljes") midis 12 muajve dhe HPK-së gjatë gjithë jetës;
- HPK shtesë për instrumente të reja financiare të njohura gjatë periudhës, si dhe rimarrje për instrumente financiare të çregjistruara në periudhë;
- Ndikimi në matjen e HPK-së për shkak të ndryshimeve në supozimet e modelit, duke përfshirë ndryshimet në PD, ED dhe HD në periudhë, që rrjedhin nga përditësimi i inputeve në modelet HPK;
- Eliminimi i zbritjes për shkak të kalimit të kohës pasi HPK matet mbi bazën e vlerës aktuale;
- Këmbimet valutore të mjeteve të shprehura në valutë dhe lëvizje të tjera; dhe
- Fshirje e provizioneve në lidhje me aktivet e fshira gjatë periudhës.

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Shënime në pasqyrat financiare***(shuma në Lek'000, përveç rasteve kur thuhet ndryshe)***13. Hua dhe paradhënie për klientët, neto (vazhdim)**

Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara në 31 dhjetor 2023 dhe 31dhjetor 2022 përfshijnë garancitë e vendosura nga dhe të dhëna klientëve si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Garancitë në favor të klientëve	11,667,647	14,812,618
Angazhime kredituese të patërhequra	9,502,614	6,675,628
Garanci nga institucionet financiare	1,008,416	965,244
Angazhime të tjera	1,246,560	2,741,520

Banka ka kolaterale të lëna peng nga klientët duke përfshirë kolateralin në para, hipotekat dhe aktive të tjera në favor të Bankës.

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***37. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara (vazhdim)**

	<b>Faza 1</b>	<b>Faza 2</b>	<b>Faza 3</b>	<b>Totali</b>
<b>Vlera kontabël bruto më 1 janar 2023</b>	<b>14,773,307</b>	<b>16,465</b>	<b>22,846</b>	<b>14,812,618</b>
Aktive të reja të krijuara ose të blera	2,874,070	-	-	<b>2,874,070</b>
Aktive të çregjistruara ose të paguara	(5,699,119)	(6,127)	(22,846)	<b>(5,728,092)</b>
Transferime ndërmjet fazave	(307,723)	8,464	8,310	<b>(290,949)</b>
Efekti i kurseve të këmbimit	-	-	-	-
<b>Vlera kontabël bruto më 31 dhjetor 2023</b>	<b>11,640,535</b>	<b>18,802</b>	<b>8,310</b>	<b>11,667,647</b>

Vlera nominale të garancive financiare, letër krediti dhe HPK e tyre janë si më poshtë:

	<b>Faza 1</b>	<b>Faza 2</b>	<b>Faza 3</b>	<b>Totali</b>
<b>Vlera kontabël bruto më 1 janar 2022</b>	<b>12,857,272</b>	<b>62,076</b>	<b>14,484</b>	<b>12,933,832</b>
Shtesa nga bashkimi me përthithje	1,130,427	6,127	22,846	<b>1,159,400</b>
Aktive të reja të krijuara ose të blera	4,427,851	-	-	<b>4,427,851</b>
Aktive të çregjistruara ose të paguara	(3,631,905)	(62,076)	(14,484)	<b>(3,708,465)</b>
Transferime ndërmjet fazave	(10,338)	10,338	-	-
<b>Vlera kontabël bruto më 31 dhjetor 2022</b>	<b>14,773,307</b>	<b>16,465</b>	<b>22,846</b>	<b>14,812,618</b>

	<b>Faza 1</b>	<b>Faza 2</b>	<b>Faza 3</b>	<b>Totali</b>
<b>Zhvlerësimi HPK me 1 janar 2023</b>	<b>95,959</b>	<b>5,996</b>	<b>14,523</b>	<b>116,478</b>
Aktive të reja të krijuara ose të blera	16,555	-	-	<b>16,555</b>
Aktive të çregjistruara ose të paguara	(38,067)	(100)	(13,461)	<b>(51,628)</b>
Transferime ndërmjet fazave	(89)	1,152	(1,063)	-
Vlera e ri-llogaritur neto e HPK	(7,145)	(6,648)	6,851	<b>(6,942)</b>
<b>Zhvlerësimi HPK më 31 dhjetor 2023</b>	<b>67,213</b>	<b>400</b>	<b>6,850</b>	<b>74,463</b>

	<b>Faza 1</b>	<b>Faza 2</b>	<b>Faza 3</b>	<b>Totali</b>
<b>Zhvlerësimi HPK me 1 janar 2022</b>	<b>109,556</b>	<b>3,417</b>	<b>9,689</b>	<b>122,662</b>
Shtesa nga bashkimi me përthithje	7,088	100	13,460	<b>20,648</b>
Aktive të reja të krijuara ose të blera	35,834	-	-	<b>35,834</b>
Aktive të çregjistruara ose të paguara	(50,623)	(3,417)	(8,626)	<b>(62,666)</b>
Transferime ndërmjet fazave	(5,896)	5,896	-	-
Vlera e ri-llogaritur neto e HPK	-	-	-	-
<b>Zhvlerësimi HPK më 31 dhjetor 2022</b>	<b>95,959</b>	<b>5,996</b>	<b>14,523</b>	<b>116,478</b>

## OTP BANK ALBANIA SH.A.

### Notes to the financial statements

(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)

#### 37. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara (vazhdim)

##### Çështje ligjore

Banka operon në një mjedis rregullator dhe ligjor, që, nga natyra, ka një element të rritur të rrezikut të qenësishme të çështjeve ligjore në operacionet e saj. Si rezultat, Banka është e përfshirë në procese të ndryshme gjyqësore nën juridiksionet shqiptare në rrjedhën e zakonshme të biznesit të saj. Banka ka kontrolle dhe politika formale për menaxhimin e pretendimeve ligjore. Bazuar në këshillat ligjore profesionale, Banka ofron dhe/ose shpalos shumat në përputhje me politikat e saj kontabël. Në fund të vitit, Banka kishte disa çështje ligjore të pazgjidhura që nuk kanë ndikim material në veprimtarinë e Bankës.

##### Angazhime qiraje

Banka ka me qira ambiente të zyrave. Qiratë kanë një maturitet mesatare prej tre deri në pesë vjet. Nuk ka kufizime të vendosura mbi qiramarrësin duke hyrë në këto kushte.

Banka ka disa kontrata qiraje që përfshijnë opsione zgjatjeje dhe përfundimi. Këto opsione negocohen nga Drejtimi për të ofruar fleksibilitet në menaxhimin e portofolit të aktiveve me qira dhe përputhshmëri me nevojat e biznesit të Bankës. Drejtimi ushtron gjykim të rëndësishëm në përcaktimin nëse këto opsione zgjatjeje dhe përfundimi janë në mënyrë të arsyeshme të sigurta për t'u ushtruar.

Të gjitha kontratat e qirasë që kanë mundësi zgjatjeje, përcaktohet se në datën e skadimit, qiramarrësi preferohet të japë sërish objektin me qira, por të dyja palët duhet të bien dakord për kushtet e reja të kontratës. Të gjitha kontratat e qirasë që kanë opsion zgjidhjeje janë të parashikuara në kontratë dhe afati i njoftimit është 1 deri në 6 muaj. Gjatë kësaj periudhe qiradhënësi përdor ambientet e objektit dhe paguan qiranë mujore dhe për kontratën në fuqi. Gjatë viteve 2023 dhe 2022 nuk ka opsione zgjatjeje dhe përfundimi që të ushtrohen pasi ushtrimet nuk janë të sigurta nga ana e Bankës.

#### 38. Transaksionet me palët e lidhura

Pala përfundimtare kontrolluese e Bankës më 31 dhjetor 2023 është OTP BANK NYRT. Një sërë transaksionesh bankare kryhen me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, depozitat dhe transaksionet e tjera të kryera në kushte normale tregtare dhe me norma tregu (transaksioni në mënyrë të barabartë).

Më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, Banka kishte kushtet dhe transaksionet e mëposhtme kontraktuale me aksionerin e saj të vetëm, OTP Bank Plc dhe CKB :

<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>Shuma</b>	<b>Norma Interesit %</b>	<b>Datë valutë</b>	<b>Data e maturimit</b>
Llogari rrjedhëse nga OTP Bank Plc	223,787	0.00	-	-
Shpenzimet e interesit për OTP Bank Plc	117,823	-	-	-
Të ardhura nga interesi për OTP Bank Plc	412,937	-	-	-
Garancia e marrë OTP Bank Plc	1,246,560	-	-	-
Shpenzimi i komisionit të garancisë	68,372	-	-	-
Llogaritë pezull me CKB	42,295	-	-	-
Llogaritë e pagueshme	26,772	-	-	-
Tarifa të tjera të të ardhurave të lidhura me kartat	24,411	-	-	-
Shpenzimet e tarifës së këmbimit	64,735	-	-	-

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***38. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)**

<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>Shuma</b>	<b>Norma Interesit %</b>	<b>Date Valute</b>	<b>Data e maturimit</b>
Llogari rrjedhëse nga OTP Bank Plc	545,329	0.00	-	-
Kredi nga OTP Bank Plc	2,855,750	3.17	30-Nov-22	4-Jan-23
Kredi nga OTP Bank Plc	913,840	3.49	30-Dec-22	3-Feb-23
Kredi nga OTP Bank Plc	2,284,600	2.29	30-Dec-22	5-Jan-23
Shpenzime interesi OTP Bank Plc	89,684	-	-	-
Të ardhura nga interesi OTP Bank Plc	60,131	-	-	-
Garanci të marra OTP Bank Plc	2,741,520	-	-	-
Shpenzim komisionesh nga garancitë	60,345	-	-	-
Llogaritë pezull me CKB	37,030	-	-	-
Llogaritë e pagueshme	5,307	-	-	-
Tarifa të tjera të të ardhurave të lidhura me kartat	6,386	-	-	-
Shpenzimet e tarifave të këmbimit	20,781	-	-	-

Më 31 dhjetor 2023, garanci të mara përbëhen nga 7 milionë EUR me afat maturimi nga 31 mars 2023 deri 31 mars 2024 dhe 5 milionë Euro me afat maturimi nga 3 qershor 2023 deri 3 mars 2024 (31 dhjetor 2022: 17 milionë Euro me afat maturiteti nga 31 mars 2022 deri 31 mars 2023 dhe 7 milionë Euro me afat maturiteti nga 3 qershor 2022 deri 6 mars 2023). Tarifa vjetore e paguar e garancisë së marë varion nga 1.34% deri 2.2% (31 dhjetor 2022: 1.34% deri në 2.2%).

	<b>Drejtore</b>		<b>Bordi Drejtues</b>	
	<b>2023</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2022</b>
<b><i>Kredi</i></b>				
Kredi gjendje në fillim të vitit	90,686	62,599	-	-
Kredi të dhëna gjatë vitit	71,141	39,604	3	-
Kredi të shlyera gjatë vitit	(34,452)	(11,517)	-	-
<b>Kredi gjendje në fund të vitit</b>	<b>127,375</b>	<b>90,686</b>	<b>3</b>	<b>-</b>
Garanci bankare të lëshuara	9	10,256	-	-
Interesa të fituara	1,429	1,250	-	-
	<b>Drejtore</b>		<b>Bordi Drejtues</b>	
	<b>2023</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2022</b>
<b><i>Llogari rrjedhëse dhe depozita</i></b>				
Depozita në fillim të vitit				
Depozita të marra gjatë vitit	103,922	148,317	8,266	13,505
Depozita të dhëna gjatë vitit	54,669	34,435	4,117	1,764
<b>Depozita gjendje në fund të vitit</b>	<b>(40,560)</b>	<b>(78,830)</b>	<b>(5,150)</b>	<b>(7,002)</b>
<b><i>Llogari rrjedhëse dhe depozita</i></b>	<b>118,032</b>	<b>103,922</b>	<b>7,233</b>	<b>8,267</b>
Interesi i paguar	(163)	(259)	-	-
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	52	161	54	11
Fitimet nga transaksionet në monedhë të huaj	-	93	-	0
Kompensimi i drejtimit	(189,622)	(150,392)	(7,254)	(4,092)

Shumat e paraqitura në lidhje me klasifikimet e Drejtorëve dhe Bordit të Drejtorëve përfshijnë anëtarë të afërt të familjeve të tyre si dhe biznese të kontrolluara, bashkërisht të kontrolluara ose të ndikuara në mënyrë të konsiderueshme nga Drejtimi i bankës, ose për rastet kur fuqia votuese e konsiderueshme bie në mënyrë direkte ose indirekte mbi çdo Drejtor ose të afërm të familjes së tij.

**39. Ngjarjet pas dates së raportimit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së raportimit që kërkon shpallje në këto pasqyra financiare përveç eventit të përshkruar në shënimin 41 h).

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***40. Analiza e aktiveve dhe detyrimeve sipas maturitetit**

Tabela më poshtë paraqet një analizë të aktiveve dhe detyrimeve të bankës të analizuara sipas kohës se kur ato pritet të rikuperohen apo të shlyhen. Aktivët dhe detyrimet financiare janë klasifikuar të maturohen dhe/ose paguhen sipas maturitetit aktual të kontratave të tyre (pa bërë ndonjë supozim mbi mundësinë e ripagimit e mëhershëm). Në lidhje me “Hua dhe paradhëniet për klientët”, banka përdor të njëjtën bazë të sjelljes së pritshme të ripagimit që u përdor për vlerësimin e NEI

	31 dhjetor 2023			31 dhjetor 2022		
	<12 muaj	>12 muaj	Totali	< 12 muaj	> 12 muaj	Totali
<b>Aktive</b>						
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	20,547,198	-	20,547,198	17,779,996	-	17,779,996
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	14,213,819	-	14,213,819	14,954,227	-	14,954,227
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	894,030	-	894,030	627,752	-	627,752
Investime në letra me vlerë me VDATGj	6,794,010	20,919,266	27,713,277	5,060,660	27,484,521	32,545,181
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	3,604,669	6,879,555	10,484,224	1,748,626	1,402,732	3,151,358
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	21,251,287	72,162,325	93,413,612	26,637,643	73,287,368	99,925,011
Qira Financiare të arkëtueshme	54,311	1,485,784	1,540,095	78,584	1,153,639	1,232,223
Aktive afatgjata materiale dhe jomateriale	-	5,359,549	5,359,549	-	4,015,556	4,015,556
Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore	-	113,488	113,488	-	187,412	187,412
Aktiv tatimor i shtyrë, neto	-	49,772	49,772	-	310,265	310,265
Aktive të tjera	1,685,703	-	1,685,703	680,369	-	680,369
Aktive me të drejtë përdorimi, neto	-	1,323,193	1,323,193	-	1,224,401	1,224,401
<b>Totali</b>	<b>69,045,027</b>	<b>108,292,932</b>	<b>17,7337,960</b>	<b>67,567,857</b>	<b>109,065,894</b>	<b>176,633,751</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime ndaj institucioneve financiare	2,067,697	99,018	2,166,715	7,656,203	979,852	8,636,055
Detyrime ndaj klientëve	126,510,962	21,832,699	148,343,661	129,999,073	17,377,419	147,376,492
Detyrime të qirasë	61,662	1,140,639	1,202,301	224,716	989,354	1,214,070
Detyrim tatimor i shtyrë, neto	-	775,526	775,526	-	-	-
Detyrime të tjera	2,819,846	-	2,819,846	1,874,217	-	1,874,217
Provizione për detyrime dhe të tjera	-	303,292	303,292	-	433,910	433,910
<b>Totali</b>	<b>131,460,167</b>	<b>24,151,174</b>	<b>155,611,341</b>	<b>139,754,209</b>	<b>19,780,535</b>	<b>159,534,744</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>(62,415,140)</b>	<b>84,141,758</b>	<b>21,726,619</b>	<b>(72,186,352)</b>	<b>89,285,359</b>	<b>17,099,007</b>

#### **41. Administrimi i rrezikut financiar**

##### **(a) Të përgjithshme**

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku kreditor
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional
- rreziku i këmbimit valutor
- rreziku i pajtueshmërisë

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të bankës ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të bankës.

##### ***Struktura e administrimit të rrezikut***

Bordi Drejtues ka përgjegjësi për ndërtimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Bordi ka themeluar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (KAD) dhe Komitetin e Rrezikut të Kredisë të Bankës, dhe atë të Rrezikut Operacional, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut në fushat e tyre specifike. Komitetet përbëhen nga anëtarë ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Bordi Drejtues.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Banka, për të vendosur kufizime dhe kontrole dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontroleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Banka nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin çdo punonjës të kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i kontrollit është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Për të kryer funksionet e veta Komiteti i Kontrollit mbështetet nga Kontrolli i Brendshëm i Bankës. Kontrolli i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt dhe 'ad-hoc' politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe raporton rezultatet e vëzhgimeve tek Komiteti i Kontrollit.

##### ***Zhvillimet aktuale***

Drejtimi i Bankës monitoron çdo ditë pozicionin e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve ndërkombëtare financiare, duke vënë në zbatim praktikën më të mira bankare. Drejtimi është i bazuar në analizat e fitimit, likuiditetit dhe kostos së fondeve dhe merr masa të përshtatshme në lidhje me kreditimin, tregun (kryesisht normën e interesit) dhe rrezikun e likuiditetit duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative të ekonomisë globale. Në këtë mënyrë, banka i përgjigjet ndryshimeve të tregut duke mbajtur një kapital dhe një pozicion likuiditeti të qëndrueshëm.

##### **(b) Rreziku i kredisë**

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga ky instrument, dhe vjen kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet për klientët, bankat e tjera dhe investimi në letra me vlerë VDATGj.

Për qëllime raportimi të administrimit të rrezikut të kredisë, Banka konsideron dhe konsolidon të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor (si rreziku që vjen nga vetë klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori). Për qëllime të administrimit të rrezikut kreditor, rreziku që vjen nga tregtimi i letrave me vlerë administrohet në mënyrë të pavarur, por raportohet si pjesë e rrezikut të ekspozimit ndaj tregut.

**41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)**

*Administrimi i rrezikut të kredisë*

Bordi Drejtues ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut tek Drejtimi Ekzekutiv i Bankës i mbikëqyrur nga zyra qendrore. Sektori i veçuar i Rrezikut të Kredisë, që raporton paralelisht tek Drejtori i Rrezikut dhe Drejtori Ekzekutiv, është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Bankës.

Administrimi i rrezikut arrihet me:

- Formulimin e politikave të kreditimit duke u konsultuar me njësitë e biznesit, duke mbuluar kërkesat për kolateral, vlerësimin e kredive, vlerësimin dhe raportimin e rrezikut dhe përputhshmërinë me ligjet dhe procedurat ligjore në fuqi.
- Krijimi dhe monitorimi i niveleve të delegimit dhe procesi i përshkallëzimit në lidhje me miratimet e kredisë. Bordi i Drejtorëve ia delegon autoritetin e tij të miratimit Anëtarëve Ekzekutiv të Bankës (më tetor 2023 është deri në Euro 6M. Mbi këtë kufi ose edhe për kufijtë më të ulët që tejkalojnë kriteret e përcaktuara në matricën e delegimit, kërkohet pëlqimi i selisë qendrore. Mbi 10% të kapitalit rregullator të OTP, bordi mbikqyrës është autoriteti përfundimtar i miratimit. Duhet të theksohet se para dorëzimit për miratimin në bordin mbikqyrës nevojitet miratimi i CLC lokal dhe selisë qendrore.

Për individët kufiri është 1.3 milion euro ose ekuivalenti i tij në Lek ose monedha të tjera.

- Menaxhimi i portofolit nëpërmjet raportimit/monitorimit
- Mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Banka vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut të kreditimit të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, para aprovimit përfundimtar të disbursimit. Rinovimet dhe rishikimet e faciliteteve janë subjekt i të njëjtit proces.
- Kufizimi i përqëndrimit të ekspozimit të palëve të kundërta. Banka strukturon nivelet e rrezikut të kreditimit që ndërmerr duke vendosur limite mbi shumën e rrezikut të pranuar në lidhje me një huamarrës ose një grup huamarrësish. Për më tepër përcakton dhe limitet e përqëndrimit sipas sektorëve të ekonomisë. Rreziqe të tilla monitorohen mbi baza të vazhdueshme dhe janë subjekt i një rishikimi vjetor ose më të shpeshtë sipas nevojës.
- Mbikëqyrja e ekspozimit aktual ndaj limiteve në mënyrë të shpeshtë. Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditimit administrohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit për të përballuar shlyerjen e principalit dhe interesit, madje dhe duke i ndryshuar dhe këto limite kreditimi kur është e përshtatshme.
- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e kategorizimit të rrezikut të Bankës në mënyrë që të kategorizojë ekspozimet sipas shkallës së rrezikut të humbjes financiare me të cilën përballen dhe të përqendrohet menaxhimi në rreziqet e shoqëruesve. Sistemi i klasifikimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se ku mund të kërkohen provizione të zhvlerësimit ndaj ekspozimeve specifike të kredisë. Kuadri aktual i klasifikimit të rrezikut është i bazuar në një kategorizim të përgjithshëm të portofolit të kredisë në kreditë performuese dhe me probleme, të klasifikuar në 3 kategori dhe nën-kategori për kryerjen e kredive (5,6,7) dhe 3 kategori të mospagimit (8, 9, 10), të cilat pasqyrojnë shkallë të ndryshme të rrezikut të dështimit dhe disponueshmërinë e kolateralit ose zbutjen e rrezikut të kredisë. Përgjegjësia për vendosjen dhe monitorimin e duhur të shkallëve të rrezikut në përputhje me situatën financiare të palës jo me pakicë mbetet me Menaxhimin e Riskut të Kredisë dhe i nënshtrohet miratimit përfundimtar nga autoriteti miratues përfundimtar i dosjes. Vlerësimi i rrezikut gjithashtu i nënshtrohet rishikimeve të rregullta të kryera nga OTP, dhe politikave dhe udhëzimeve të matjes së rrezikut dhe dëmtimit të Grupit.



**41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)****Administrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)**

Referencat e mëposhtme tregojnë se ku vlerësimi i zhvlerësimit të Bankës dhe metoda e matjes është përcaktuar në këtë raport. Duhet lexuar së bashku me *Përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit*.

Përcaktimi dhe vlerësimi i Bankës për mospagim dhe përmirësim	Shënimi 41 (b) (i)
Një shpjegim i sistemit të brendshëm të vlerësimit të Bankës	Shënimi 41 (b) (ii)
Si Banka përcakton, llogarit dhe monitoron probabilitetin e mospagimit, ekspozimit në momentin e mospagimit dhe humbjen e mospagimit	Shënimi 41 (b) (iii), Shënimi 40 (b) (iv) & Shënimi 41 (b) (xi)
Kur Banka konsideron se ka pasur një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë nga një ekspozim	Shënimi 41 (b) (v)
Politika e Bankës për ndarjen e mjeteve financiare në të cilën HPK vlerësohet në baza kolektive	Shënimi: 41 (b) (vi)
Detajet e llogaritjeve HPK për aktivet e Fazës 1, Fazës 2 dhe Fazës 3	Shënimi: 6 (j) (iv)

**i) Përkufizimi i mospagimit dhe përmirësimit**

Banka konsideron një instrument financiar në vështirësi pagese dhe për këtë arsye e klasifikon në Fazën 3 (të zhvlerësuar për riskun nga kredia) për llogaritjet e HPK në të gjitha rastet kur huamarrësi del më shumë se 90 ditë në vonesë nga pagesat e tij kontraktuale. Banka përcakton një instrument financiar si të papaguar, i cili është plotësisht i përafëruar me përkufizimin e kredive me probleme, kur plotëson njërin nga kriteret e mëposhtme:

1. Pamundësia për të paguar ("UTP"): Klienti dështon në pagesa për shkak të pamundësisë për të paguar (tregohet në dosjen e indikatorëve të parazgjedhur) dhe njëkohësisht ka së paku 1 financim aktiv, ose
  - a. vështirësi të konsiderueshme financiare të emetuesit ose të obliguesit;
  - b. një shkelje e kontratës, si një vonesë ose delikuencë në pagesat e interesit ose të principalit;
  - c. kreditori, për arsye ekonomike ose ligjore që lidhen me vështirësitë financiare të huamarrësit, duke i dhënë huamarrësit një koncesion që kreditori nuk do ta merrte në konsideratë;
  - d. bëhet e mundur që huamarrësi të hyjë në falimentim ose riorganizim tjetër financiar;
  - e. mungesa e një tregu aktiv për aktivin financiar për shkak të vështirësive financiare; ose
  - f. të dhënat e vëzhgueshme që tregojnë se ka një ulje të matshme në flukset monetare të ardhshme të vlerësuara nga një grup i aktiveve financiare që nga njohja fillestare e këtyre aktiveve, edhe pse rënia nuk mund të identifikohet ende me aktivet individuale financiare në grup, duke përfshirë:
    - i. ndryshime negative në statusin e pagesave të huamarrësve në grup (e.g., Shënimi 40)
    - ii. një numër në rritje pagesash të vonuara; ose
    - iii. kushtet kombëtare ose lokale ekonomike që lidhen me mospagimin e aktiveve në grup (p.sh. një rritje në shkallën e papunësisë në zonën gjeografike të huamarrësve, një rënie në çmimet e pronës për hipotekat në zonën përkatëse, një rënie në çmimet e naftës për financim të aktiveve ndaj prodhuesve të naftës, ose ndryshimeve të pafavorshme në kushtet e industrisë që ndikojnë huamarrësit në grup);ose
2. 90 ditë në vonesë: Ekspozimi është më shumë se 90 ditë në vonesë dhe në të njëjtën kohë është aktive dhe shënohet si në vonesë nga banka (ky identifikim është i nevojshëm sepse për disa financime me pagesa / financime të pabarabarta, llogaria e ditëve në vonesë nuk reflekton saktë kohën e kaluar nga mospagimi).

Kriteret e mësipërme janë zbatuar për të gjitha instrumentet financiare të mbajtura nga Banka dhe janë në përputhje me përkufizimin e mospagimit të përdorur për qëllime të menaxhimit të brendshëm të rrezikut të kredisë

**41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)**

*Administrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)*

**i) Përkufizimi i mospagimit dhe kurimi (vazhdim)**

Është politika e Bankës që të konsiderojë një instrument financiar si 'të kuruar' dhe prandaj ta ri-klasifikojë nga Faza 3, kur asnjë nga kriteret e paracaktuara nuk kanë qenë të pranishëm për të paktën tre muaj rresht. Vendimi nëse do të klasifikohet një aktiv si Faza 2 ose Faza 1 pasi është kuruar varet nga grada e përditësuar e kredisë, në kohën e kurimit dhe nëse kjo tregon se ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë në krahasim me njohjen fillestare. Dalja nga vonesa mund të mos ndodhë para një periudhe minimale prej një viti pas ristrukturimit dhe në përputhje me pajtueshmërinë me marrëveshjen e ristrukturuar dhe mungesën e ndonjë pagese të prapambetur, siç shpjegohet në Shënimin 6 (k) (viii).

Bazuar në udhëzimin e EBA për zbatimin e përkufizimit të mospagimit sipas nenit 178 të Rregullores (BE) nr. 575/2013, Banka ka miratuar përkufizimin e ri të mospagimit i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2021. Pragu i materialitetit është një shumë kufi e përcaktuar që merret parasysh kur vlerësohet statusi i mospagimit. Duke mos marrë parasysh ditët e vonuara, shumat e mëposhtme konsiderohen jomateriale për uljen e detyrimeve kreditore të palëve në një status të mospaguar. Nëse shumat e vonuar kalon këtë kufi, ajo duhet të konsiderohet materiale. Ekzaminimi i pragut të materialitetit duhet të kryhet për pjesën e vonuar të ekspozimit. Shumata e vonuar përfshin gjithmonë të gjitha detyrimet e papaguara të klientit, d.m.th., interesat, tarifat dhe borxhin kryesor.

Në rastin e segmentit individë:

- Pragu absolut: 100 EUR ose
- Pragu relativ: raporti i totalit të borxhit të prapambetur të klientit kalon 1% të shumës së kontraktuar.

Në rastin e segmentit korporate:

- Pragu absolut: 500 EUR ose
- Pragu relativ: raporti i totalit të borxhit të prapambetur të klientit kalon 1% të shumës së kontraktuar.

Mospagimi konsiderohet se ka ndodhur në lidhje me një detyrim të caktuar kur një ose të dyja nga dy ngjarjet e mëposhtme kanë ndodhur:

- Debitori vonohet për më shumë se 90 ditë radhazi për çdo detyrim kredie material (ditëvonesë > 90 & pragu i materialitetit)

Ditët e vonuara fillojnë të numërohen ditën tjetër pas pagesës së humbur dhe rritet me çdo ditë kalendarike derisa të bëhet një pagesë nga klienti.

**(ii) Vlerësimi i brendshëm i Bankës dhe vlerësimi i probabilitetit të dështimit**

Departamenti i pavarur i rrezikut i Bankës administron modelin e saj të brendshëm të klasifikimit për portofolin jo-“me pakicë” dhe siguron pajtueshmërinë totale të vlerësimit, gjendjen financiare të palës jobankare dhe normën e provizionimit. Pjesa e portofolit të shëndetshëm e klasifikuar si Faza 1 duhet të klasifikohet midis normave 5- (vlerësimi i vendit shqiptar) dhe 7+. Pjesa e portofolit në ndjekje që është ekuivalente me Fazën 2, duhet të klasifikohet 8 ose 9- dhe Faza 3 duhet të klasifikohet me normën 10. Modelet përfshijnë informacionin sasior dhe cilësor dhe, përveç informacionit specifik të huamarrësit, shfrytëzojnë dhe informacion shtesë të jashtëm që mund të ndikojë në sjelljen e huamarrësit.

PD që lidhen me secilin vlerësim përdoren më pas për modelimin e llogaritjeve të SNRF 9 HPK, duke përfshirë informacionin e kërkuar përpara dhe klasifikimin e ekspozimit sipas SNRF 9.

**41. Administrimi i rrezikut financiar**

**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)**

*Administrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)*

**(ii) Vlerësimi i brendshëm i Bankës dhe vlerësimi i probabilitetit të dështimit (vazhdim)**

**Thesari, tregtia dhe marrëdhëniet ndërbankare**

Thesari, marrëdhëniet tregtare dhe ndërbankare të Bankës dhe palët e tjera përfshijnë institucionet e shërbimeve financiare, bankat, agjentët-dilerët, shkëmbimet dhe zyrat e kleringut. Për këto marrëdhënie, miratimi për listën e gjelbër të palëve lëshohet nga departamenti i rrezikut të tregut të Zyrës Qendrore të OTP Bank NYRT në përputhje me “**Agjencinë e Vlerësimit**” të palës dhe cakton vlerësimin e brendshëm të shkallës. Rreziku i tregut lokal monitoron limitet e dhëna për këto palë në frekuenca të ndryshme (ditore/mujore/tre mujore dhe vjetore).

**Kreditimi i korporatave dhe bizneseve të vogla**

Për kreditë e korporatave, huamarrësit vlerësohen nga punonjës të specializuar të rrezikut të Bankës. Vlerësimi i rrezikut të kredisë bazohet në një vlerësim të specializuar dhe merr parasysh informacione të ndryshme historike, aktuale dhe të ardhme, si p.sh:

- Informacion financiar historik së bashku me parashikimet dhe buxhetet e përgatitura nga klienti. Ky informacion financiar përfshin rezultatet e realizuara dhe të pritshme, raportet e aftësisë paguese, raportet e likuiditetit dhe çdo raport tjetër përkatës për të matur performancën financiare të klientit.
- Çdo informacion i disponueshëm publikisht për klientët nga palët e jashtme. Kjo përfshin notat e jashtme të vlerësimit të lëshuara nga agjencitë e vlerësimit nëse janë të disponueshme, raportet e analistëve të pavarur, çmimet e obligacioneve të tregtuara publikisht, CDS ose njoftimet në shtyp dhe artikuj.
- Çdo informacion makro-ekonomik ose gjeopolitik, p.sh., rritja e PBB-së e rëndësishme për industrinë specifike dhe segmentet gjeografike ku operon klienti.
- Çdo informacion tjetër objektivisht i mbështetur mbi cilësinë dhe aftësitë e menaxhimit të klientit, i rëndësishëm për performancën e kompanisë.
- Sjelljet e kreditimit të palëve në sistemin bankar.
- Cilësia dhe lehtësia e projektit në kërkesë për financim.

**Huatë konsumatore dhe huatë hipotekore**

*Produktet e huadhënies me pakicë të pasiguruara dhe të siguruara*

Huadhënia e pasiguar përfshin hua personale/ekspres, qira financiare, overdraft dhe karta krediti të ndryshueshme. Ndërsa e siguruara përfshin hipotekat me llojet e saj të diferencuara sipas afatit dhe destinacionit si pasuritë e paluajtshme, banesat, kapitalin për shtëpi dhe huatë e ristrukturimit.

Huatë e pambuluara nga konsumatori kanë burimin nga paga ose të ardhurat nga qiraja miratohen nga një sistem pikësh i ndërtuar brenda bankës që cakton statusin e miratimit ose refuzimit për të gjitha aplikimet që kalojnë përmes rrjedhës së aplikimit. Karta statistikore merr parasysh të gjitha politikat e kreditit dhe kriteret e rrezikut në fuqi duke u bazuar me një pikë përfundimtare dhe duke e krahasuar me një vlerë kufi për vendimin përfundimtar

**41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)***Administrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)***(ii) Vlerësimi i brendshëm i Bankës dhe vlerësimi i probabilitetit të dështimit (vazhdim)****Huatë konsumatore dhe huatë hipotekore (vazhdim)***Produkte të huadhënies me pakicë të pasiguruara dhe të siguruara (vazhdim)*

Të gjitha huatë e siguruara analizohen fillimisht në nivel dege dhe miratimi përfundimtar bëhet nga një ekip i specializuar në rrezikun e kreditit që vlerëson aftësinë e klientit për të mbështetur financiarisht shlyerjen e kredisë së dhënë gjatë jetës së kredisë dhe cilësinë e kolateralit si burim dytësor i shlyerjes.

Duke filluar nga T3-2020 për kreditë e pasiguruara dhe nga T3-2021 për produktet e kreditimit të siguruara, është zbatuar një mjet statistikor vlersimi brenda një procesi/aplikacioni kreditimi.

Ne hartën e vlerësimit janë zbatuar edhe kriteret e politikës së riskut dhe procesi i vendimmarrjes është i automatizuar duke i mundësuar analistit të rrezikut të marrë vendimin përfundimtar për miratimin ose refuzimin e rasteve të aplikimit për kredi

Klientët pasi shënohen, ata vlerësohen në bazë të shkallës Master të grupit OTP, ku vlerësimi 10 u caktohet sipas definicionit klientëve të papaguar

<b>VLERESIMI</b>	<b>PD e ulët</b>	<b>PD e lartë</b>
1	0.00%	0.27%
2	0.27%	0.53%
3	0.53%	0.93%
4	0.93%	1.56%
5	1.56%	2.62%
6	2.62%	4.36%
7	4.36%	8.07%
8	8.07%	19.78%
9	19.78%	<100%
10 (Mospagim në kohë)		100%

**(iii) Ekspozimi në dështim – ED**

Ekspozimi në dështim është shuma e pritshme e pashlyer në momentin e mospagimit e cila përbëhet nga pjesa e balancës që detyrohet dhe pjesa e përdorshme jashtë balancit nga klienti në momentin e mospagimit dhe është e zbatueshme për klientët që nuk kanë probleme mospagimi në periudhën /muajin e vëzhgimit ose në 12 muajt e ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur. ED-të 12-mujore dhe përgjatë jetëgjatësisë përcaktohen në bazë të profilit të pritshëm të pagesës, i cili ndryshon sipas llojit të produktit. Për produktet që amortizohen dhe financimet që ripaguhën me një shumë të vetme, kjo bazohet në ripagimet kontraktuale që i detyrohen huamarrësit gjatë një periudhe 12 mujore ose përgjatë jetës së produktit.

Për të llogaritur ED për një hua të fazës 1, Banka vlerëson ngjarjet e mundshme në vonesë brenda 12 muajve për llogaritjen e 12 muaj-HPK. Megjithatë, nëse një kredi në fazën 1 që pritet të jetë në vonesë në 12 muajt nga data e bilancit dhe pritet gjithashtu të rikuperohet dhe pastaj të rivendoset përsëri në vonesë, atëherë merren parasysh të gjitha ngjarjet e paracaktuara të lidhura. Për aktivet financiare të Fazës 2, Fazës 3 dhe POCl, ekspozimi në vonesë konsiderohet për ngjarjet gjatë jetës së instrumentave.

Banka përcakton ED-të duke modeluar gamën e rezultateve të mundshme të ekspozimit në pika të ndryshme në kohë, që korrespondon me skenarët e shumëfishtë. PD-të e SNRF 9 u caktohen pastaj grupeve homogjene bazuar në rezultatin e modeleve të Bankës.

**41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)****Administrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)****(iv) Probabiliteti i dështimit - PD**

Probabiliteti i dështimit paraqet mundësinë e një huamarrësi të mos paguajë detyrimin e tij financiar gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë gjithë jetës së mbetur të detyrimit. Si rregull, probabiliteti i jetës së parazgjedhur llogaritet duke përdorur probabilitetin rregullator 12 muajsh të paracaktuar, të zhveshur nga çdo diferencë e konservatorizmit, si pikë fillestare. Pas kësaj, metodat e ndryshme statistikore përdoren për të gjeneruar një vlerësim se si profili i parazgjedhur do të zhvillohet nga pika e njohjes fillestare gjatë gjithë jetës së financimit ose portofolit të financimeve.

**(v) Humbja në rast dështim - HD**

OBA me ndihmën e grupit përcakton HD për ekspozimet e vlerësuara kolektivisht:

- Huatë hipotekore të PI me pakicë dhe portofolet jo pakicë (MSE dhe MLE) që janë të siguruara në mënyrë të konsiderueshme me hipotekë: metodologjia e modifikuar HD bazuar në Rishikimin e Cilësisë së Aktiveve (AQR). Burimi kryesor i të dhënave është rikuperimi i parave të gatshme. Të dhënat e kolateralit merren parasysh vetëm nëse një ekspozim është Hipotekë/MSE/MLE dhe lloji kryesor i kolateralit është RRE ose CRE. Normat e rikuperimit nga kolaterali zbatohen vetëm për marrëveshjet që janë siguruar nga kolateral(et) e pasurive të paluajtshme në kohën e mospagesës (nëse një marrëveshje e caktuar është në mospagim) ose janë të siguruara nga kolateral(et) e pasurive të paluajtshme në një datë të caktuar raportimi (nëse marrëveshja nuk ka dështuar).
- PI: Huatë konsumatore, financat e RMK dhe ekspozimet e pasigurta: metodologjia HD e bazuar në rikuperim, e vlerësuar nga të dhënat historike

Llogaritja (vlerësimi) HD nuk duhet të identifikohet automatikisht me të dhënat aktuale historike. Drejtimi dhe shkalla e zhvendosjes së faktorëve që ndikojnë në HD, duke pasur parasysh edhe efektet makroekonomike, krahas zhvillimeve të parashikuara në to, duhet të analizohen gjithmonë. Rezultati i analizave, si një lloj derivimi i vlerës së HD nga vlerat e realizuara, duhet të dokumentohet. Duhet pasur parasysh se ashtu si PD, HD-ja nuk është as e pavarur nga ciklet e biznesit; zakonisht rritet paralelisht me rënien ekonomike.

Një vlerësim i veçantë HD duhet të bëhet për ekspozimet tashmë në gjendje absorbuese duke përdorur të njëjtat parime. Ekspozimet e menaxhuara nga kompanitë e faktoringut duhet të kenë të njëjtën vlerë neto në nivel të konsoliduar - diferencat e mundshme mund të ndodhin vetëm për arsye kontabël ose diskrecioni kombëtar - që do të thotë se e njëjta metodologji, supozime dhe parametra duhet të përdoren në faktoring dhe në nivel të konsoliduar

Kur vlerësohet HD për kreditë në gjendje absorbuese duhet të merren parasysh edhe sa vijon:

- Përcaktimi i një periudhe të përshtatshme stërvitjeje përmes së cilës ka të ngjarë të ndodhin rikuperimet
- Koha e kaluar tashmë në statusin absorbues
- Efekti i kohës së kaluar tashmë në gjendjen absorbuese duhet të pasqyrohet siç duhet në parametrat e vlerësuar (p.sh. RPF)
- Çdo ngjarje që ndodh gjatë procesit të stërvitjes duhet të përfshihet në parametra (e.x. ankandi i pasuksesshëm i një pasurie të paluajtshme)

OBA Dërgon të dhëna historike për të gjitha segmentet e klientëve të PI, MSE dhe MLE nga Q1 2014 në selinë qendrore. E gjithë puna e modelimit dhe PD-të finale 12M + kohëzgjatje janë vënë në dispozicion nga ekipi i modelimit në selinë qendrore. Frekuenca e përsëritjes së ushtrimit është cdo vit, cdo TM4 të vitit.

Të dhëna të mëtejshme të kohëve të fundit dhe skenarë ekonomikë largpamës përdoren për të përcaktuar normën e HD sipas SNRF 9 për çdo grup instrumentash financiarë. Kur vlerësohet informacioni largpamës, pritshmëria bazohet në skenarë të shumtë. Shembujt e inputeve kryesore përfshijnë ndryshime në statusin e pagesës ose faktorë të tjerë që janë tregues të humbjeve në grup.

Banka vlerëson HD rregullatore dhe SNRF 9 mbi një bazë të vetme. Sipas SNRF 9, normat e HD vlerësohen për Fazën 1, Fazën 2, Fazën 3 dhe POCI SNRF 9 segmentin e secilës klasë aktive. Inputet për këto norma të HD vlerësohen dhe, aty ku është e mundur, kalibrohen përmes testimit të mëparshëm kundrejt rikuperimeve të fundit. Këto përsëriten për çdo skenar ekonomik sipas rastit.

**41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)**

*Administrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)*

**(vi) Rritje e ndjeshme e rrezikut kreditor**

Banka vazhdimisht monitoron të gjitha aktivet që i nënshtrohen HPK-ve. Për të përcaktuar nëse një instrument ose një portofol instrumentesh i nënshtrohet 12 muaj HPK ose HPK përgjatë jetës, Banka vlerëson nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare. Banka konsideron një ekspozim që është rritur ndjeshëm në rrezikun e kredisë kur SNRF 9 - PD përgjatë jetës është dyfishuar që nga njohja fillestare dhe është rritur me më shumë se 10 ditë në vonesë (pika tregtare fillestare).

Banka zbaton gjithashtu një metodë të mesme cilësore për të nxitur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë për një aktiv, siç është lëvizja e një klienti / objekti në listën e vrojtimeve ose llogaria që bëhet për t'u siguruar. Në raste të caktuara, Banka mund të konsiderojë gjithashtu që ngjarjet e shpjeguara në Shënimin 41 (b) (i) janë një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë në krahasim me një vonesë. Pavarësisht ndryshimit në notat e kredisë, nëse pagesat kontraktuale janë më shumë se 10 ditë të kaluara, rreziku i kredisë konsiderohet të jetë rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.

Kur vlerësohen HPK-të në baza kolektive për një grup aktivesh të ngjashme (siç përcaktohet në Shënimin 41 (b) (vi)) Banka zbaton të njëjtat parime për të vlerësuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare.

**(vi) Grupimi i aktiveve financiare të matura në bazë kolektive**

Siç shpjegohet në Shënimin 6 j (vi) B në varësi të faktorëve më poshtë, Banka llogarit HPK ose në bazë kolektive ose individuale. Klasa e aktiveve ku banka llogarit HPK në baza individuale përfshijnë:

- të gjithë klientët që në datën e raportimit janë klasifikuar në Fazën 3 dhe kanë ED prej të paktën 0.4 M EUR
- natyrën specifike të financimit dhe kushtet e tij kontraktuale dhe financiare (maturimi, norma e referenc, etj);
- profilin e ekspozimit deri në maturim në lidhje me lëvizjet e mundshme të tregut.
- ekzistenca e kolateralit ose garancive; dhe
- potenciali për të dalë në vonesë bazuar në vlerësimin e rrezikut të brendshëm.
- Thesari, tregtia dhe marrëdhëniet ndërbankare (të tilla si detyrimet nga bankat, kolaterali në formën e parasë së gatshme për letrat me vlerë të huazuara dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe instrumentet e borxhit me kosto të amortizuar / VDATGj
- Ekspozimet që janë klasifikuar si POCI kur kredia fillestre ishte çregjistruar dhe një e re u njoh si rezultat i një ristrukturimi të borxhit të drejtuar nga kredia.

**41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)**

*Administrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)*

**(vii) Grupimi i aktiveve financiare të matura në bazë kolektive (vazhdim)**

Klasa e aktiveve ku Banka llogarit HPK-në në baza kolektive përfshijnë

- Individë dhe biznes në Fazën 1 dhe 2
  - Balancat e huasë më pak se 400,000 Euro
  - Ekspozimet e POCI të blera të menaxhuara në baza kolektive
- Banka e grupon këtë ekspozim në portofole më të vogla homogjene, bazuar në një kombinim të brendshëm dhe karakteristikat e jashtme të kredive që përbëjnë një grup homogjen.
- Kreditimi jo-me pakicë është grupuar në një kategori, pa nënndarje
  - Grupet homogjene të kreditimit me pakicë si më poshtë:
    - Kreditë hipotekare
    - Kreditë profesionale dhe bizneseve shumë të vogla
    - Kreditë konsumatore
    - Kredi të tjera

**(viii) Informacionet e ardhshme**

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe llogaritja e humbjeve të pritshme kreditore, të dyja përfshijnë informacionin e ardhshëm. Banka ka kryer analiza historike dhe ka identifikuar variabla kryesorë ekonomike që ndikojnë në rrezikun e kredisë dhe humbjet e pritshme të kredisë për çdo portofol.

Kjo arrihet duke aplikuar skenarë të ndryshëm makroekonomikë me shumën 100% të peshave, të cilat mund të integrohen në parametrat PD, HD dhe ED.

Banka dërgon të dhënat historike në Selinë Qëndrore. Të gjithë skenarët makroekonomikë të punës së modelimit janë vënë në dispozicion nga ekipi i modelimit në tremujorin kryesor. Frekuenca e përsëritjes së ushtrimit është çdo vit, në tremujorin e katërt të vitit.

Ndikimi i variablave ekonomike në probabilitetin e dështimit dhe humbjen e dhënë të mospagimit përcaktohet duke përdorur regresionin statistikor për të kuptuar ndikimin që ndryshimet në këto variabla kanë pasur historikisht në normat e mospagimit dhe në komponentët e humbjes së dhënë në mospagim dhe ekspozimit në mospagim.

Përveç skenarit bazë ekonomik, modeli ofron gjithashtu një skenar të rastit më të mirë dhe të rastit më të keq dhe peshime të skenarit për të siguruar që të kapet jolineariteti. Banka ka arritur në përfundimin se tre ose më pak skenarë kapin në mënyrë të përshtatshme jolinearitetin. Ponderimet e skenarit përcaktohen nga një kombinim i analizave statistikore, duke marrë parasysh gamën e rezultateve të mundshme për të cilat përfaqëson secili skenar i zgjedhur.

Banka konsideron se këto parashikime përfaqësojnë vlerësimin e saj më të mirë të rezultateve të mundshme dhe mbulojnë çdo jolinearitet dhe asimetri të mundshme në portofolet e ndryshme të Bankës.

**41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)***Administrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)***(ix) Humbjet e Pritshme Kreditore - Të përgjithshme**

Llogaritja e humbjeve të pritshme kreditore kërkon përdorimin e vlerësimeve kontabël të cilat, sipas përkufizimit, rrallë do të jenë të barabarta me rezultatet aktuale. Drejtimi i Bankës ushtron gjykim në zbatimin e politikave kontabël të Bankës.

Banka vlerëson në bazë të parashikimit humbjet e pritshme kreditore të lidhura me aktivet e instrumentit të tij të borxhit të mbartura me koston e amortizuar dhe VDATGj dhe me ekspozimin që rrjedhin nga angazhimet e financimit, dhënia me qira e të arkëtueshmeve dhe kontratat e garancisë financiare. Banka njuh një humbje provizioni për humbje të tilla në çdo datë raportimi.

Instrumentat financiarë në Fazën 1 kanë humbjen e pritshme të tyre kreditore të matur në një shumë të barabartë me pjesën e humbjeve të pritshme kreditore që rezultojnë nga ngjarjet e mundshme gjatë 12 muajve të ardhshëm. Instrumentat në Fazat 2 ose 3 kanë humbjet e pritshme kreditore të matura në bazë të humbjeve të pritura kreditore përgjatë gjithë jetës. Sipas SNRF 9, kur matet humbja e pritshme kreditore, është e nevojshme të merret parasysh informacioni i ardhshëm.

**(x) Shpjegimi i Inputeve, Supozimeve dhe Teknikave të Vlerësimit**

Humbja e pritshme e kredisë matet në bazë të një periudhe 12-mujore ose jetëgjatësie në varësi të faktit nëse ka ndodhur një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare ose nëse një aktiv konsiderohet si i dëmtuar nga kredia. Informacioni ekonomik i avancuar gjithashtu përfshihet në përcaktimin e PD-së dhe ED-së 12-mujore dhe përgjatë gjithë jetës. Këto supozime ndryshojnë sipas llojit të klientëve të ndarë në Biznes dhe Individë. Humbjet e pritshme të kredisë janë produkti i skontuar i probabilitetit të dështimit (PD), humbjes në rast dështimit (HD) dhe ekspozimit në rast dështimit (ED).

**(xi) Analiza e ndjeshmërisë**

Supozimet më të rëndësishme që ndikojnë në humbjen e pritshme të humbjes së kredisë janë si më poshtë:

Portofolet e biznesit

• PBB-ja tremujore sipas metodës së prodhimit, rregulluar nga sezoni - Çmimet aktuale të PBB-së:

- Industria
- Shërbimet e Pronave të Paluajtshme
- VSHB Vlera e Shtuar Bruto
- PBB Produkti i Brendshëm Bruto

• PBB-ja tremujore sipas qasjes së shpenzimeve, çmimet konstante

- Shpenzimet e Konsumit Final
- Formimi i Kapitalit Fiks Bruto
- Absorbimi Vendor
- Eksporti Neto
- Importi
- Eksporti

Portofoli me pakicë i Tregut të Punës

- Anketa e Forcave të Punës:
  - Shkalla e Papunësisë
  - Pjesëmarrja në Fuqinë Punëtore
- Çmimet
  - Indeksi i Çmimeve të Konsumit (CPI)
  - Indeksi i çmimeve të Prodhimit (PPI)



**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)***Administrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)***(xi) Analiza e ndjeshmërisë (vazhdim)****Kolaterali dhe përmirësime të tjera të kredisë**

Banka mban kolateral kundrejt të arkëtueshmeve financiare në formën e interesave hipotekare mbi pronën, letrat me vlerë të tjera të regjistruara mbi pasuritë dhe garancitë. Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huamarrjes dhe përditësohen me frekuencë trevjeçare dhe gjithashtu kur aktivi vlerësohet individualisht si i zhvlerësuar. Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateralit të mbajtur kundrejt të arkëtueshmeve financiare më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 është paraqitur më poshtë:

	<b>2023</b>		<b>2022</b>	
	<b>Mbi kolateralizuar</b>	<b>Mbi kolateralizuar</b>	<b>Mbi kolateralizuar</b>	<b>Mbi kolateralizuar</b>
	<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>	<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>	<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>	<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>
Prona te paluajtshme	203,363,766	3,971,055	189,502,968	5,172,036
Inventar makineri e paisje	73,958,613	2,406,056	66,934,728	1,517,562
Para të gatshme si kolateral	3,103,637	57,212	1,527,086	132,990
Të tjera	9,689,977	79,172	13,831,496	1,840,622
<b>Total</b>	<b>290,115,993</b>	<b>6,513,495</b>	<b>271,796,278</b>	<b>8,663,210</b>

Kolaterali në përgjithësi nuk kërkohet për balancat me bankat dhe institucionet financiare, dhe nuk ka kolateral të tillë të mbajtur më 31 dhjetor 2023 ose 2022.

Efekti financiar i kolateralit paraqitet duke ndarë vlerën e kolateralit veçmas

- (i) ato aktive ku vlera e kolateralit është e barabartë ose mbivendoset me vlerën kontabël të aktiveve (mbi-kolateralizuara), dhe
- (ii) ato aktive ku vlera e kolateralit është më e vogël se vlera kontabël e aktiveve (nën kolateralizuara).

Banka mban kolateral kundrejt huave dhe paradhëniesve ndaj klientëve. Banka zbaton udhëzimet e saj të brendshme për pranueshmërinë e klasave specifike të kolateralit ose zbutjen e rrezikut të kredisë. Banka mban kolateral kryesisht në formën e:

- Hipotekat e pasurive të paluajtshme mbi pronat e banimit si dhe të biznesit;
- Premtimi mbi aktivet e biznesit në veprim, si makineritë dhe pajisjet, inventarët dhe llogaritë e arkëtueshme;
- Kolaterali i parasë së gatshme dhe disa letra me vlerë (p.sh. Obligacione Qeveritare), etj.

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)***Administrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)***(xi) Analiza e ndjeshmërisë (vazhdim)****Kolaterali dhe përmirësime të tjera të kredisë (vazhdim)**

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit të Bankës për monedhat e huaja menaxhohet në nivel të Grupit OTP brenda kuadrit të konceptit të grupit të likuiditetit. Sipas tij, një pjesë e konsiderueshme e rreziqeve të likuiditetit mbulohet nga një grup i përbashkët likuiditeti - i menaxhuar nga OTP Bank - që siguron akses të menjëhershëm për të gjithë anëtarët e grupit, ndërsa filialet duhet të mbajnë rezervën e tyre të likuiditetit për rreziqet që janë të vështira për t'u matur dhe menaxhohen nga selia. Në këtë kuadër rreziku i likuiditetit lidhur me pozicionet në monedhën shqiptare (LEK) nuk administrohet nga OTP Group. Banka duhet të menaxhojë pozicionet e likuiditetit në lekë dhe rrezikun përkatës në nivel lokal.

Në fushën e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, Banka zbaton metodologjitë e mëposhtme në përputhje me kërkesat rregullatore dhe të kompanisë mëmë, e cila mundëson matjen e pozicionit aktual dhe të ardhshëm të likuiditetit. Banka menaxhon ekspozimin e saj ndaj rrezikut pjesërisht nga administrimi dhe analiza e pozicioneve të likuiditetit, pjesërisht duke përcaktuar kufijtë e brendshëm për ekspozimet ndaj rrezikut.

Banka duhet së pari të jetë në përputhje me rregulloren vendore të parashikuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë për administrimin e rrezikut të likuiditetit. Rregulloret e likuiditetit të nxjerra nga Banka e Shqipërisë janë:

- Rregullorja nr. 71 “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”, datë 14.10.2009.
- Rregullorja nr. 27, “Për raportin e mbulimit të likuiditetit”, hyrë në fuqi më 1.3.2020.
- Vendimi nr. 70, datë 2.12.2020 “Për raportin neto të financimit të qëndrueshëm të bankave”; ka hyrë në fuqi në janar 2023.

**41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)***Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit (vazhdim)**Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)*

Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë nr. 71 Banka është e detyruar të respektojë raportet e likuiditetit (aktive likuide/detyrime afatshkurtra) si më poshtë

- **Raporti i likuiditetit total:**  
(të gjithë artikujt në monedhë)  
*Aktivët likuide / Detyrimet afatshkurtra  $\geq 20\%$*
- **Raporti i likuiditetit në monedhën vendase:**  
(zëra në lekë)  
*Aktivët likuide / Detyrimet afatshkurtra  $\geq 15\%$*
- **Raportet e likuiditetit të monedhave të tjera:**  
(zëra të tjerë në valutë të huaj)  
*Aktivët likuide / Detyrimet afatshkurtra  $\geq 20\%$*

Banka ka qenë shumë mbi kufijtë rregullatorë gjatë vitit 2023. Raporti i likuiditetit total është dhjetor 2023 është 35.2 % (dhjetor 2022: 36.90%).

Raporti i Mbulimit të Likuiditetit (RML) brenda 1 muaji raportohet çdo muaj sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë për RML.

Krahasuar me kufirin rregullator lokal (100%) për RML totale, një objektiv i brendshëm më i rreptë është përcaktuar në nivelin 110%. Në rast të shkeljes së këtij kufiri, menaxhimi aktiv bëhet i nevojshëm për të shmangur shkeljen e kufirit rregullator. Ndërkohë për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme kufiri rregullator vendor nuk është më i ulët se 80%.

Banka ka qenë shumë mbi kufijtë rregullatorë gjatë vitit 2023. *Raporti i mbulimit të likuiditetit total (RML) në dhjetor 2023 është 303.2% (dhjetor 2022: 198.5%) shumë mbi kufirin rregullator jo më të ulët se 100%. Raporti përkatës RML në valutë të huaj menaxhohet me grupin e likuiditetit të OTP Group.*

Sipas rregullores RML të Bankës së Shqipërisë një kufi i valutave totale është përcaktuar të paktën 100% dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme të paktën 80% është në fuqi nga 1 mars 2020. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë për raportin e detyrueshëm të raportit të qëndrueshëm të financimit neto (NSFR) raportohet në baza tremujore.

Krahasuar me kufirin rregullator lokal (100%) për NSFR-në totale, një objektiv i brendshëm më i rreptë përcaktohet në nivelin 105%.

Banka ka qenë shumë mbi kufijtë rregullatorë gjatë vitit 2023. *Raporti Total Neto i Financimit të qëndrueshëm (NSFR) në dhjetor 2023 është 164% shumë mbi kufirin rregullator jo më të ulët se 100%.*

Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë për raportin neto të financimit të stabilitetit (NSFR), një kufi i valutave totale është përcaktuar të paktën 100% dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme të paktën 70%-100% është në fuqi nga 1 janar 2023. Zbatimi i monedhës së rëndësishme RNFS është gradualisht si më poshtë:

**MONEDHA TOTALE E RËNDËSISHME NSFR**

- 1 janar 2023 70%
- 1 janar 2024 80%
- 1 janar 2025 100%

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)*****Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit (vazhdim)***

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të likuiditetit të aktiveve dhe detyrimeve financiare sipas maturimeve kontraktuale më 31 dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1 deri në 3 muaj</b>	<b>3 deri në 6 muaj</b>	<b>6 deri në 12 muaj</b>	<b>1 deri në 5 vjet</b>	<b>Mbi 5 vjet</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktive</b>							
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	20,547,198	-	-	-	-	-	<b>20,547,198</b>
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	14,213,819	-	-	-	-	-	<b>14,213,819</b>
Hua dhe paradhënie ndaj institucioneve financiare	33,032	218,878	590,052	52,068	-	-	<b>894,030</b>
Investime në letra me vlerë me VDATGj	849,264	1,029,434	1,229,981	3,685,333	14,252,269	6,666,996	<b>27,713,277</b>
Investime në letra me vlerë me kosto të amotizuar			1,752,091	1,852,578	6,879,555		<b>10,484,224</b>
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	3,767,097	2,792,821	4,816,265	9,875,103	23,800,742	48,361,584	<b>93,413,612</b>
Qiratë financiare të arkëtueshme	1,308	3,033	6,379	43,591	1,438,273	47,511	<b>1,540,095</b>
Aktive të tjera	1,121,065	-	-	564,638	-	-	<b>1,685,703</b>
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>40,532,783</b>	<b>4,044,166</b>	<b>8,394,768</b>	<b>16,073,311</b>	<b>46,370,839</b>	<b>55,076,091</b>	<b>170,491,958</b>
<b>Detyrime</b>							
Detyrime ndaj institucioneve financiare dhe bankave	378,902	519	-	1,688,275	99,019	-	<b>2,166,715</b>
Detyrime ndaj klientëve	82,421,715	5,034,866	8,033,010	31,021,372	19,063,143	2,769,555	<b>148,343,661</b>
Qira financiare	26,005	188	332	35,137	347,437	793,202	<b>1,202,301</b>
Detyrime të tjera	366,764	1,744,497	-	708,585	-	-	<b>2,819,846</b>
Borxhi i varur	-	-	-	-	775,526	-	<b>775,526</b>
<b>Total i detyrimeve</b>	<b>83,193,386</b>	<b>6,780,070</b>	<b>8,033,342</b>	<b>33,453,369</b>	<b>20,285,125</b>	<b>3,562,757</b>	<b>155,308,049</b>
<b>Ekspozimi</b>	<b>(42,660,603)</b>	<b>(2,735,904)</b>	<b>361,426</b>	<b>(17,380,058)</b>	<b>26,085,714</b>	<b>51,513,334</b>	<b>15,183,909</b>
<b>Efekti kumulativ</b>	<b>(42,660,603)</b>	<b>(45,396,507)</b>	<b>(45,035,081)</b>	<b>(62,415,139)</b>	<b>(36,329,425)</b>	<b>15,183,909</b>	<b>-</b>

Drejtimi beson se pavarësisht se një pjesë e konsiderueshme e llogarive të klientëve janë depozita pa afat, diversifikimi i këtyre depozitave sipas numrit dhe llojit të depozituesve, dhe përvoja e kaluar e bankës do të tregonte se këto llogari klientësh ofrojnë një burim afatgjatë dhe të qëndrueshëm financimi për Bankën.

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të likuiditetit të aktiveve dhe detyrimeve financiare sipas maturimeve kontraktuale më 31 dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

<b>Aktive</b>	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1 deri në 3 muaj</b>	<b>3 deri në 6 muaj</b>	<b>6 deri në 12 muaj</b>	<b>1 vit deri në 5 vjet</b>	<b>Mbi 5 vjet</b>	<b>Totali</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	17,779,996	-	-	-	-	-	<b>17,779,996</b>
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	14,954,227	-	-	-	-	-	<b>14,954,227</b>
Hua dhe paradhënie ndaj institucioneve financiare	627,752	-	-	-	-	-	<b>627,752</b>
Investime në letra me vlerë me VDATGj	713	1,327,708	608,946	3,123,297	20,683,191	6,801,326	<b>32,545,181</b>
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	-	-	-	1,748,626	1,402,732	-	<b>3,151,358</b>
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	5,588,451	4,964,818	8,260,996	7,824,068	24,103,646	49,183,032	<b>99,925,011</b>
Qiratë financiare të arkëtueshme	2,693	2,116	7,906	65,869	1,153,639	-	<b>1,232,223</b>
Aktive te tjera	523,686	-	-	156,683	-	-	<b>680,389</b>
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>39,477,518</b>	<b>6,294,642</b>	<b>8,877,848</b>	<b>12,918,543</b>	<b>47,343,208</b>	<b>55,984,358</b>	<b>170,896,117</b>
<b>Detyrime</b>							
Detyrime ndaj institucioneve financiare dhe bankave	1,050,379	5,593,628	953,619	58,577	622,264	357,588	<b>8,636,055</b>
Detyrime ndaj klientëve	88,003,560	6,899,297	10,368,143	24,728,073	14,919,652	2,457,767	<b>147,376,492</b>
Qira financiare	-	15,328	1,059	5,863	239,437	952,383	<b>1,214,070</b>
Detyrime te tjera	10,115	1,460,886	-	403,216	-	-	<b>1,874,217</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>89,064,054</b>	<b>13,969,139</b>	<b>11,322,821</b>	<b>25,195,729</b>	<b>15,781,353</b>	<b>3,767,738</b>	<b>159,100,834</b>
<b>Ekspozimi</b>	<b>(49,586,536)</b>	<b>(7,674,497)</b>	<b>(2,444,973)</b>	<b>(12,277,186)</b>	<b>31,561,855</b>	<b>52,216,620</b>	<b>11,795,283</b>
<b>Efekti kumulativ</b>	<b>(49,586,536)</b>	<b>(57,261,033)</b>	<b>(59,706,006)</b>	<b>(71,983,192)</b>	<b>(40,421,337)</b>	<b>11,795,283</b>	<b>-</b>



**41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**(d) Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si norma e interesit, normat e këmbimit valutor dhe diferencat e kredisë (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të debitorit / emetuesit) do të ndikojnë në të ardhurat e Bankës ose në vlerën e zotërimeve të instrumentave financiarë të saj. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin e rrezikut. Strategjia e Bankës për menaxhimin e rrezikut për librin e saj bankar është e ndryshme për secilën nga kategoritë e mëposhtme të rrezikut të tregut dhe është përcaktuar në nënseksionet vijuese të këtyre pasqyrave financiare, si më poshtë:

**Administrimi i rrezikut të tregut**

Banka e ndan ekspozimin e saj ndaj rrezikut të tregut midis portofolit tregtar dhe atij jotregtar. Portofoli i tregtimit përfshin ato pozicione që rrjedhin nga transaksionet e krijimit të tregut ku Banka vepron si principal me klientët ose me tregun, së bashku me aktivet dhe detyrimet financiare që menaxhohen mbi bazën e vlerës së drejtë. Pozicioni i këmbimit valutor trajtohet si pjesë e portofolit tregtar të Bankës për qëllime të menaxhimit të rrezikut. Portofolet jotregtare lindin kryesisht nga administrimi i normave të interesit të aktiveve dhe detyrimeve bankare me pakicë dhe tregtare të njësisë ekonomike. Portofolet jotregtare gjithashtu përbëhen nga rreziqet që rrjedhin nga investimet e Bankës të mbajtura deri në maturim dhe ato të disponueshme për shitje. Autoriteti i përgjithshëm për rrezikun e tregut i është dhënë Komitetit të Menaxhimit të Aktiveve dhe Detyrimeve (KAD). KAD është përgjegjëse për zhvillimin e politikave të detajuara të menaxhimit të rrezikut dhe ndjekjen e rregullt të zbatimit të tyre. Kufijtë e rrezikut të tregut miratohen përfundimisht nga Bordi.

Në një nivel operacional, rreziku i tregut menaxhohet kryesisht nga departamenti i thesarit të Bankës, i cili është përgjegjës për të siguruar që ekspozimet e Bankës janë në përputhje me kufijtë e rrezikut të tregut të miratuar nga Bordi dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura kur është e nevojshme.

**Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut - portofole të tregtueshme**

Banka është e ekspozuar ndaj efektit të luhatjeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja në pozicionin e saj financiar dhe fluksit të parasë.

**Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit**

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut valutor nëpërmjet transaksioneve në valuta të huaja. Duke qenë se monedha në të cilën Banka paraqet pasqyrat e saj financiare është Leku Shqiptar, pasqyrat financiare të Bankës ndikohen nga lëvizja në kurset e këmbimit midis Lekut dhe monedhave të tjera. Rreziku i monedhës është rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhetet për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor. Në përputhje me politikën e Bankës, pozicionet llogariten nga Departamenti i Financës dhe monitorohen çdo ditë nga Departamenti i Riskut dhe përdoren strategji mbrojtëse për të siguruar që pozicionet të mbahen brenda kufijve të përcaktuar.

Kufijtë për pozicionet neto që Banka mund të mbajë në secilën monedhë kryesore, si dhe kufiri individual për çdo monedhë tjetër janë përcaktuar si më poshtë:

Në mijë Lek	EUR	USD	CAD	CHF	GBP	XAU
2023	562,500	437,500	62,500	62,500	62,500	6,250
2022	562,500	437,500	62,500	62,500	62,500	6,250

Analiza e ndjeshmërisë së monedhës më poshtë llogarit efektin e një lëvizjeje të arsyeshme të mundshme të kursit të monedhës kundrejt lekut (të gjithë variablat e tjerë janë konstantë) në pasqyrën e të ardhurave (për shkak të vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve monetare të ndjeshme ndaj monedhës) dhe kapitalit (nr. kapitali special ose instrumentet mbrojtëse që ndikojnë në ndjeshmërinë e kapitalit, kështu që efekti është i njëjtë me ndjeshmërinë e fitimit dhe humbjes). Një shumë negative në tabelë pasqyron një reduktim të mundshëm neto në pasqyrën e të ardhurave ose kapitalit, ndërsa një shumë pozitive pasqyron një rritje të mundshme neto. Një ulje ekuivalente e secilës prej valutave më poshtë kundrejt lekut do të rezultonte në një ndikim të barabartë, por të kundërt.

Rritje/(Zvoglim) në pikët bazë	Ndjeshmëria e fitimit para tatimit	31 dhjetor 2023		31 dhjetor 2022	
		Ndjeshmëria e kapitalit	Ndjeshmëria e fitimit para tatimit	Ndjeshmëria e kapitalit	Ndjeshmëria e fitimit para tatimit
LEK	+ / (-) 100	(113,806)	113,806	(184,207)	184,207
USD	+ / (-) 100	39,660	(39,660)	33,358	(33,358)
EURO	+ / (-) 100	405,159	(405,159)	158,510	(158,510)

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(d) Rreziku i tregut (vazhdim)**

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare sipas monedhave më 31 dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

	<b>Lek</b>	<b>EUR</b>	<b>USD</b>	<b>Të tjera</b>	<b>Total</b>
<b>Aktivet</b>					
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	3,669,484	12,100,079	2,945,930	1,831,705	<b>20,547,198</b>
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	3,976,843	9,646,408	590,568	-	<b>14,213,819</b>
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	860,998	33,032	-	-	<b>894,030</b>
Investime në letra me vlerë me VDATGj	19,542,023	7,755,095	416,158	-	<b>27,713,276</b>
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	9,700,796	783,428	-	-	<b>10,484,224</b>
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	49,578,732	43,555,392	279,488	-	<b>93,413,612</b>
Qiratë financiare të arkëtueshme	186,287	1,353,695	113	-	<b>1,540,095</b>
Aktive të tjera	1,394,780	277,322	12,339	1,262	<b>1,685,703</b>
Aktive afatgjata materiale	4,964,802	2,432	-	-	<b>4,967,234</b>
Aktive afatgjata jomateriale	392,315	-	-	-	<b>392,315</b>
Aktive me të drejtë përdorimi, neto	1,323,193	-	-	-	<b>1,323,193</b>
Aktive tatimore të shtyra, neto	49,772	-	-	-	<b>49,772</b>
Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore	113,488	-	-	-	<b>113,487</b>
<b>Total i aktivitet</b>	<b>95,753,513</b>	<b>75,506,883</b>	<b>4,244,596</b>	<b>1,832,967</b>	<b>177,337,960</b>
<b>Detyrimet</b>					
Detyrime ndaj institucioneve financiare dhe bankave	455,312	1,531,676	177,743	1,984.00	<b>2,166,715</b>
Detyrime ndaj klientëve	69,333,272	72,998,077	4,187,201	1,825,111	<b>148,343,661</b>
Detyrime të tjera	2,558,905	387,383	(134,152)	7,711	<b>2,819,847</b>
Detyrime të qirasë	393,275	674,001	135,025	-	<b>1,202,301</b>
Boxhi i varur	-	775,526	-	-	<b>775,526</b>
Provizione të tjera	274,532	28,760	-	-	<b>303,292</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>73,015,296</b>	<b>76,395,423</b>	<b>4,365,817</b>	<b>1,834,806</b>	<b>155,611,342</b>
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>21,726,619</b>	-	-	-	<b>21,726,619</b>
<b>Pozicioni Neto</b>	<b>22,738,217</b>	<b>(888,540)</b>	<b>(121,221)</b>	<b>(1,839)</b>	<b>21,726,619</b>

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***41. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(d) Rreziku i tregut (vazhdim)**

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare sipas monedhave më 31 dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

	<b>Lek</b>	<b>EUR</b>	<b>USD</b>	<b>Të tjera</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivët</b>					
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	4,577,466	10,749,353	553,277	1,899,900	<b>17,779,996</b>
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	3,911,156	10,430,581	612,490	-	<b>14,954,227</b>
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	616,467	11,285			<b>627,752</b>
Investime në letra me vlerë me VDATGj	23,579,397	8,510,472	455,312	-	<b>32,545,181</b>
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	2,285,537	865,821	-	-	<b>3,151,358</b>
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	41,711,181	55,290,579	2,923,251		<b>99,925,011</b>
Qiratë Financiare të arkëtueshme	48,141	1,183,583	499	-	<b>1,232,223</b>
Aktive të tjera	408,153	243,444	7,831	20,941	<b>680,369</b>
Aktive afatgjata materiale, neto	3,520,252	-	-	-	<b>3,520,252</b>
Aktive afatgjata jomateriale, neto	495,304	-	-	-	<b>495,304</b>
Aktive me të drejtë përdorimi, neto	1,224,401	-	-	-	<b>1,224,401</b>
Aktive të marra në pronësi në rrugë ligjore	310,265				<b>310,265</b>
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	-	187,412	-	-	<b>187,412</b>
<b>Totali i aktivitet</b>	<b>82,687,720</b>	<b>87,472,530</b>	<b>4,552,660</b>	<b>1,920,841</b>	<b>176,633,751</b>
<b>Detyrimet</b>					
Detyrime ndaj institucioneve financiare	647,891	7,931,252	56,903	9	<b>8,636,055</b>
Detyrime ndaj klientëve	66,274,868	74,690,811	4,558,255	1,852,558	<b>147,376,492</b>
Detyrime të tjera	488,701	1,080,714	285,966	18,836	<b>1,874,217</b>
Detyrime të qirasë	70,591	846,562	296,917	-	<b>1,214,070</b>
Detyrime tatimore të shtyra, neto	342,079	81,535	10,296	-	<b>433,910</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>67,824,130</b>	<b>84,630,874</b>	<b>5,208,337</b>	<b>1,871,403</b>	<b>159,534,744</b>
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>11,488,001</b>	<b>5,611,006</b>	-	-	<b>17,099,007</b>
<b>Pozicioni Neto</b>	<b>14,863,590</b>	<b>2,841,656</b>	<b>(655,677)</b>	<b>49,438</b>	<b>17,099,007</b>

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***41. Administrimi i rrezikut financiar (Vazhdim)****(d) Rreziku i tregut (vazhdim)*****Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit – portofoli jo i tregtueshëm***

Rreziku primar ndaj të cilit janë ekspozuar portofolet jo të tregtueshme është rreziku i humbjeve nga luhatjet e flukseve të ardhshme të parasë ose vlerës së drejtë të instrumentave financiarë për shkak të ndryshimit në normat e interesit të tregut.

KAD përkufizon dhe rishikon politikën e përcaktimit të normës së interesit për aktivet dhe detyrimet financiare.

Tabela në vijim tregon ndjeshmërinë ndaj një ndryshimi të arsyeshëm të mundshëm të normave të interesit (të gjitha variablat e tjerë janë konstantë) të pasqyrës së të ardhurave të Bankës. Ndjeshmëria e pasqyrës së të ardhurave është efekti i ndryshimeve të supozuara në normat e interesit në fitim ose humbje për një vit, në bazë të normës së luhatshme të aktiveve financiare dhe të detyrimeve financiare të mbajtura më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022. Ndjeshmëria totale e kapitalit supozohet të jetë e njëjtë me ndjeshmërinë në fitim dhe humbje dhe bazohet në supozimin se ka zhvendosje paralele në kurbën e normave të interesit.

Administrimi i rrezikut të normës së interesit ndaj hendekut të limiteve të normave të interesit është plotësuar përmes monitorimit të luhatshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës sipas skenarëve standartë dhe të ndryshëm të normës së interesit. Skenarët standartë që janë konsideruar çdo muaj përfshijnë ndryshimin me 100 pikë në rënie ose ngritje paralele në të gjithë kurbat e normave të interesit.

Një analizë e luhatshmërisë së Bankës ndaj rritjes ose zvogëlimit të normës së interesit me 100 pikë (duke supozuar asnjë lëvizje asimetrike në kurbat e normave dhe pozicionit financiar konstant) paraqitet si më poshtë:

<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>Skenar deri në një vit</b>		<b>Skenar mbi 1 vit</b>	
	<b>100 pikë rritje</b>	<b>100 pikë zvogëlim</b>	<b>100 pikë rritje</b>	<b>100 pikë zvogëlim</b>
Efekti i vlerësuar fitim / (humbje)	173,784	(173,784)	(459,433)	459,433
<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>Skenar Deri në një vit</b>		<b>Skenar Mbi një vit</b>	
	<b>100 pikë rritje</b>	<b>100 pikë zvogëlim</b>	<b>100 pikë rritje</b>	<b>100 pikë zvogëlim</b>
Efekti i vlerësuar fitim / (humbje)	176,558	(176,558)	(206,755)	206,755

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(d) Rreziku i tregut (vazhdim)**

Rendimentet mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 ishin si më poshtë:

	Norma mesatare e ponderuar e interesit (Lek)		Norma mesatare e ponderuar e interesit (USD)		Norma mesatare e ponderuar e interesit (EUR)	
	2023	2022	2023	2022	2023	2022
<b>31 dhjetor</b>						
<b>Aktivet</b>						
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	-	-	-	-	-	-
Shuma të kufizuara me Bankën Qendrore	3.25%	2.75%	-	-	0.00%	0.00%
Hua dhe paradheniet ndaj institucinet financiare	4.17%	3.54%	-	-	7.66%	1.88%
Investimi në letra me vlerë të borxhit VDATGj	5.42%	5.25%	6.12%	-	2.47%	0.00%
Investimi në letrat me vlerë të borxhit me kosto të amortizuar	4.66%	4.94%	-	6.12%	0.91%	0.91%
Hua dhe paradhënie klientëve (përfshirë të arkëtueshmet e qirasë financiare)	5.95%	5.77%	7.98%	4.52%	6.66%	2.56%
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime ndaj institucionet financiare dhe bankave	1.58%	1.52%	0.00%	0.00%	3.05%	2.89%
Detyrime ndaj klientëve	0.87%	0.90%	0.29%	0.19%	0.21%	0.07%

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(d) Rreziku i Tregut (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme ofron një analizë të analizës së riçimit të normës së interesit të Bankës për aktivet dhe detyrimet financiare më 31 dhjetor 2023. Aktivet dhe detyrimet e Bankës përfshihen me vlerën kontabël dhe kategorizohen sipas datës së riçimit kontraktual ose datës së maturimit.

	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1 deri 3 muaj</b>	<b>3 deri 6 muaj</b>	<b>6 deri 12 muaj</b>	<b>Mbi 1 vit</b>	<b>Pa interes</b>	<b>Vlera kontabël</b>
<b>Aktivët</b>							
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	4,153,751	-	-	-	-	16,393,447	<b>20,547,198</b>
Shuma të kufizuara me Bankën Qendrore	14,213,819	-	-	-	-	-	<b>14,213,819</b>
Hua dhe paradheniet ndaj institucinet financiare	-	222,251	585,867	52,879	-	33,033	<b>894,030</b>
Investimi në letra me vlerë të borxhit VDATGj	10,307,718	7,029,948	6,896,809	3,478,802	-	-	<b>27,713,277</b>
Investimi në letrat me vlerë të borxhit me KA	1,185,229	4,556,673	4,638,544	103,778	-	-	<b>10,484,224</b>
Hua për klientët, vlera neto	7,737,737	12,180,488	18,815,715	37,464,536	17,215,136	-	<b>93,413,612</b>
Të arkëtueshmet e qirasë financiare	80,217	269,981	332,757	812,972	44,168	-	<b>1,540,095</b>
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>37,678,471</b>	<b>24,259,341</b>	<b>31,269,692</b>	<b>41,912,967</b>	<b>17,259,304</b>	<b>16,426,480</b>	<b>168,806,255</b>
<b>Detyrimet</b>							
Detyrime ndaj institucionet financiare dhe bankave	378,902	519	-	1,688,275	99,019	-	<b>2,166,715</b>
Detyrime ndaj klientëve	82,421,715	5,034,866	8,033,010	31,021,372	19,063,144	2,769,554	<b>148,343,661</b>
Borxhi i varur	-	-	-	-	775,526	-	<b>775,526</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>82,800,617</b>	<b>5,035,385</b>	<b>8,033,010</b>	<b>32,709,647</b>	<b>19,937,689</b>	<b>2,769,554</b>	<b>151,285,902</b>
<b>Ekspozimi</b>	<b>(45,122,146)</b>	<b>19,223,956</b>	<b>23,236,682</b>	<b>9,203,320</b>	<b>(2,678,385)</b>	<b>13,656,926</b>	<b>17,520,353</b>
<b>Efekti kumulativ</b>	<b>(45,122,146)</b>	<b>(25,898,190)</b>	<b>(2,661,508)</b>	<b>6,541,812</b>	<b>3,863,427</b>	<b>17,520,353</b>	<b>-</b>

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(d) Rreziku i Tregut (vazhdim)**

Analiza e riçimit të normës së interesit të Bankës më 31 dhjetor 2022 është si më poshtë:

	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1 deri 3 muaj</b>	<b>3 deri 6 muaj</b>	<b>6 deri 12 muaj</b>	<b>Mbi 1 vit</b>	<b>Pa interes</b>	<b>Vlera kontabël</b>
<b>Aktive</b>							
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	5,218,658	-	-	-	-	12,561,338	<b>17,779,996</b>
Shuma të kufizuara me Bankën Qendrore	14,954,227	-	-	-	-	-	<b>14,954,227</b>
Hua dhe parashenja për institucionet financiare	-	-	616,329	-	-	11,423	<b>627,752</b>
Investimi në letra me vlerë të borxhit VDATGj	8,556,867	5,637,567	5,257,501	13,093,241	-	-	<b>32,545,176</b>
Investimi në letrat me vlerë të borxhit me KA	-	-	346,842	2,804,516	-	-	<b>3,151,358</b>
Hua për klientët, vlera neto	9,197,237	17,886,744	24,218,368	36,217,141	12,405,520	-	<b>99,925,010</b>
Të arkëtueshmet e qirasë financiare	71,417	167,160	285,306	704,721	3,619	-	<b>1,232,223</b>
<b>Totali Aktive</b>	<b>37,998,406</b>	<b>23,691,471</b>	<b>30,724,346</b>	<b>52,819,619</b>	<b>12,409,139</b>	<b>12,572,761</b>	<b>170,215,742</b>
Detyrime ndaj institucionet financiare dhe bankave	6,644,007	953,619	58,577	622,264	357,588	-	<b>8,636,055</b>
Detyrime ndaj klientëve	88,003,586	6,899,297	10,368,143	24,728,073	14,919,626	2,457,767	<b>147,376,492</b>
<b>Totali Detyrime</b>	<b>94,647,593</b>	<b>7,852,916</b>	<b>10,426,720</b>	<b>25,350,337</b>	<b>15,277,214</b>	<b>2,457,767</b>	<b>156,012,547</b>
<b>Ekspozimi</b>	<b>(56,649,187)</b>	<b>15,838,555</b>	<b>20,297,626</b>	<b>27,469,282</b>	<b>(2,868,075)</b>	<b>10,114,994</b>	<b>14,203,195</b>
<b>Efekti kumulativ</b>	<b>(56,649,187)</b>	<b>(40,810,632)</b>	<b>(20,513,006)</b>	<b>6,956,276</b>	<b>4,088,201</b>	<b>14,203,195</b>	<b>-</b>

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(e) Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare**

*i) Vlera e drejtë e instrumenteve financiar* Kjo tabelë përfshin aktivet dhe detyrimet financiare për të cilat vlera e drejtë përafrohet me vlerën kontabël. Banka ka përcaktuar se për aktivet dhe detyrimet financiare që (a) kanë një maturim afatshkurtër (më pak se tre muaj), (b) janë likuide dhe (c) janë instrumente me normë të ndryshueshme, vlerat e tyre kontabël (të cilat janë neto prej zhvlerësimi aty ku është e zbatueshme) janë një përafrim i arsyeshëm i vlerës së tyre të drejtë. Instrumente të tilla përfshijnë: paratë e gatshme dhe gjendjet me bankat qendrore; për shkak dhe detyrim nga bankat.

Aktivet dhe Detyrimet Financiare	31 dhjetor 2023				Vlera e drejtë Totali
	Vlera kontabël				
		Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	
<b>Aktive Financiare</b>					
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	20,547,198	-	20,547,198	-	<b>20,547,198</b>
Shuma të kufizuara me Bankën Qendrore	14,213,819	-	14,213,819	-	<b>14,213,819</b>
Hua dhe paradhënie për institucionet financiare	894,030	-	-	894,030	<b>894,030</b>
Instrumentet e borxhit me kosto të amortizuar	10,484,224	763,615	9,805,026	-	<b>10,568,641</b>
Aktive e tjera	1,685,703	-	-	1,685,703	<b>1,685,703</b>
Hua dhe paradhënie për klientët	93,413,612	-	-	98,450,331	<b>98,450,331</b>
Të arkëtueshmet e qirasë financiare	1,540,095	-	-	1,664,865	<b>1,664,865</b>
<b>Totali i aktiveve financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë</b>	<b>142,778,681</b>	<b>763,615</b>	<b>44,566,043</b>	<b>102,694,929</b>	<b>148,024,587</b>
<b>Detyrimet financiare</b>					
Detyrime ndaj institucionet financiare dhe bankave	2,166,715	-	2,166,715	-	<b>2,166,715</b>
Detyrime ndaj klientëve	148,343,661	-	-	145,604,558	<b>145,604,558</b>
Detyrime të tjera	2,819,846	-	-	2,819,846	<b>2,819,846</b>
<b>Totali i detyrimeve financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë</b>	<b>153,330,222</b>	<b>-</b>	<b>2,166,715</b>	<b>148,424,404</b>	<b>150,591,119</b>
<b>Zërat jashtë bilancit</b>					
Garancitë financiare	<b>11,117,415</b>	-	-	11,117,415	<b>11,117,415</b>
Letër kredi për klientët	<b>550,232</b>	-	-	550,232	<b>550,232</b>
Angazhime të tjera	<b>9,502,614</b>	-	-	9,502,614	<b>9,502,614</b>
<b>Totali i zërave jashtë bilancit</b>	<b>21,170,261</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>21,170,261</b>	<b>21,170,261</b>



**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(e) Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)****i) Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë (vazhdim)**

Aktivet dhe Detyrimet Financiare	31 dhjetor 2022				
	Vlera kontabël	Vlera e drejtë			Totali
		Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	
<b>Aktivet Financiare</b>					
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	17,779,996	-	17,779,996	-	17,779,996
Shuma të kufizuara me Bankën Qendrore	14,954,227	-	14,954,227	-	14,954,227
Hua dhe paradhënie për institucionet financiare	627,752	-	-	627,752	627,752
Instrumentet e borxhit me kosto të amortizuar	3,151,358	865,821	2,285,537	-	3,151,358
Aktive e tjera	680,369	-	-	680,369	680,369
Hua dhe paradhënie për klientët	99,925,011	-	-	100,577,026	100,577,026
Të arkëtueshmet e qirasë financiare	1,232,223	-	-	1,368,140	1,368,140
<b>Totali i aktiveve financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë</b>	<b>138,350,936</b>	<b>865,821</b>	<b>35,019,760</b>	<b>103,253,287</b>	<b>139,138,868</b>
<b>Detyrimet financiare</b>					
Detyrime ndaj institucionet financiare dhe bankave	8,636,055	-	8,636,055	-	8,636,055
Detyrime ndaj klientëve	147,376,492	-	-	144,940,772	144,940,772
Detyrime të tjera	1,874,217	-	-	1,874,217	1,874,217
<b>Totali i detyrimeve financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë</b>	<b>157,886,764</b>	<b>-</b>	<b>8,636,055</b>	<b>146,814,989</b>	<b>155,451,044</b>
<b>Zërat jashtë bilancit</b>					
Garancitë financiare	13,448,987	-	-	13,448,987	13,448,987
Letër kredi për klientët	1,363,631	-	-	1,363,631	1,363,631
Angazhime të tjera	6,675,628	-	-	6,675,628	6,675,628
<b>Totali i zërave jashtë bilancit</b>	<b>21,488,246</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>21,488,246</b>	<b>21,488,246</b>

**41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**(e) Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare**

**Metodologjitë e vlerësimit të instrumenteve financiare që nuk maten me vlerën e drejtë**

Më poshtë janë metodologjitë dhe supozimet e përdorura për të përcaktuar vlerat e drejta të instrumenteve financiare të mësipërme të cilat nuk regjistrohen dhe maten me vlerën e drejtë në pasqyrat financiare të Bankës. Këto vlera të drejta ishin llogaritur vetëm për qëllime të zbulimit. Metodologjitë dhe supozimet e mëposhtme lidhen vetëm me instrumentet në tabelat e mësipërme dhe, si të tilla, mund të ndryshojnë nga teknikat dhe supozimet e shpjeguara në Shënimin 6 (xi).

*Hua dhe paradhënie për klientët*

Huatë dhe paradhëniet janë paraqitur neto nga provizionet për zhvlerësim. Portofoli i kredisë së Bankës ka një vlerë të drejtë afërsisht të barabartë me vlerën e tij kontabël për shkak të natyrës së luhatshme të normave të interesit, me kreditë që riçmohen brenda ciklit një vjeçar, me përjashtim të një grupi kredish të dhëna në vitin 2008 të cilat janë dhënë pa një dysheme minimale e aplikueshme.

*Të arkëtueshmet e qirasë financiare*

Kontratat e qirasë financiare kanë një vlerë të drejtë që është e përafërt me vlerën e tyre kontabël. Afati mesatar i këtyre kontratave është më tepër afatmesëm ose afër maturimit dhe me normë interesi të ndryshueshme, e cila riçmohet brenda ciklit një vjeçar.

*Detyrime ndaj klientëve*

Vlera e drejtë e detyrimeve ndaj klientëve është vlerësuar duke përdorur teknikën e skontimit të fluksit monetar, duke aplikuar normat që ofrohen për depozitat me maturime dhe kushte të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkesës është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

*Borxhi i varur*

Vlera e drejtë e borxhit të varur përafrohet me vlerën nominale të borxhit. Borxhi i varur përdoret si input i nivelit 3 në hierarkinë e vlerës së drejtë.

*Pozicionet jashtë bilancit*

Vlera e drejtë e vlerësuar e pozicioneve jashtë bilancit bazohet në çmimet e tregut për instrumente të ngjashme ose në modele të skontuara të flukseve monetare, siç shpjegohet më sipër, të cilat përfshijnë elementin e rrezikut të kredisë nëpërmjet faktorit të skontimit.

Tabela e mëposhtme tregon një analizë të instrumenteve financiare të regjistruara me vlerën e drejtë sipas nivelit të vlerës së drejtë hierarkie:

<b>Aktive financiare</b>	<b>31 dhjetor 2023</b>			
	<b>Niveli 1</b>	<b>Niveli 2</b>	<b>Niveli 3</b>	<b>Totali</b>
Investime në letrat me vlerë të borxhit VDATGj	8,171,253	19,542,023	-	<b>27,713,277</b>
<b>Totali i aktiveve financiare të matura me vlerën e drejtë</b>	<b>8,171,253</b>	<b>19,542,023</b>	<b>-</b>	<b>27,713,277</b>

  

<b>Aktive financiare</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>			
	<b>Niveli 1</b>	<b>Niveli 2</b>	<b>Niveli 3</b>	<b>Totali</b>
Investime në letrat me vlerë të borxhit VDATGj	8,965,784	23,579,397	-	<b>32,545,181</b>
<b>Totali i aktiveve financiare të matura me vlerën e drejtë</b>	<b>8,965,784</b>	<b>23,579,397</b>	<b>-</b>	<b>32,545,181</b>

**OTP BANK ALBANIA SH.A.****Notes to the financial statements***(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)***41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(e) Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)**

Për qëllime të matjes, SNRF 9 “Instrumentet financiare: Njohja dhe matja”, klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: a) instrumentet e borxhit me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse (VDATGj dhe (b) aktivet financiare me kosto të amortizuar.

Më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, të gjitha instrumentet financiare maten me koston e amortizuar, me përjashtim të investimeve në letra me vlerë të cilat maten me vlerën e drejtë.

	31 dhjetor 2023			31 dhjetor 2022		
	Vlera kontabël	Kosto Amortizuar	VDATGj	Vlera kontabël	Kosto Amortizuar	VDATGj
<b>Aktivët</b>						
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	20,547,198	20,547,198	-	17,779,996	17,779,996	-
Shuma të kufizuara me Bankën Qendrore	14,213,819	14,213,819	-	14,954,227	14,954,227	-
Huatë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare	894,030	894,030	-	627,752	627,752	-
Aktive e tjera	1,685,703	1,685,703	-	680,369	680,369	-
Instrumentet e borxhit në VDATGj	27,713,277	-	27,713,277	32,545,181	-	32,545,181
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	10,484,224	10,484,224	-	3,151,358	3,151,358	-
Hua dhe paradhënie për klientët	93,413,612	93,413,612	-	99,925,011	99,925,011	-
Të arkëtueshmet e qirasë financiare	1,540,095	1,540,095	-	1,232,223	1,232,223	-
<b>Total i aktiveve</b>	<b>170,491,958</b>	<b>142,778,681</b>	<b>27,713,277</b>	<b>170,896,117</b>	<b>138,350,936</b>	<b>32,545,181</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime ndaj institucionet financiare dhe bankave	2,166,715	2,166,715	-	8,636,055	8,636,055	-
Detyrime ndaj klientëve	148,343,661	148,343,661	-	147,376,492	147,376,492	-
Detyrime të tjera	2,819,846	2,819,846	-	1,874,217	1,874,217	-
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>153,330,222</b>	<b>153,330,222</b>	<b>-</b>	<b>157,886,764</b>	<b>157,886,764</b>	<b>-</b>

**41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****(f) Rreziku operacional**

Rreziku operacional është rreziku i humbjes direkte ose indirekte që vjen nga një sërë shkaqesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Bankës, si dhe nga faktorë të jashtëm të ndryshëm nga rreziqet e kreditit, të tregut dhe të likuiditetit, si ato që rrjedhin nga kërkesat ligjore dhe rregullatore dhe standardet përgjithësisht të pranura të sjelljes së korporatës. Rreziqet operacionale lindin nga të gjitha operacionet e Bankës dhe përballen nga të gjitha entitetet.

Objektivi i Bankës është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Bankës me efektivitetin e përgjithshëm të kostos dhe të shmangë procedurat e kontrollit që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin.

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe zbatimin e kontroleve për të adresuar rrezikun operacional i është caktuar menaxhmentit të lartë brenda çdo njësie biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për rakordimin dhe monitorimin e transaksioneve;
- pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore dhe kërkesat e tjera ligjore;
- dokumentacionin e kontroleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rreziqeve operacionale me të cilat përballen, dhe përshtatshmërinë e kontroleve dhe procedurave për të adresuar rreziqet e identifikuar;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operacionale dhe masat e propozuara korrigjuese;
- zhvillimi i planeve të emergjencës;
- trajnim dhe zhvillim profesional;
- standardet etike dhe të biznesit; dhe
- zbutja e rrezikut, duke përfshirë sigurimin kur kjo është efektive

Pajtueshmëria me standardet e Bankës mbështetet nga një program rishikimesh periodike të ndërmarra nga struktura specifike të rrezikut operacional si dhe nga auditimi i brendshëm.

**(g) Rreziku i pajtueshmërisë**

Rreziku i pajtueshmërisë përfshin rrezikun e pajtueshmërisë rregullatore dhe ligjore. Rreziku i pajtueshmërisë është rreziku që Banka pëson rrezik financiar ose reputacional përmes vendosjes së gjobave ose penalteteve si rezultat i mosrespektimit të ligjeve, rregullave dhe rregulloreve në fuqi dhe praktikave të mira të tregut (përfshirë standardet etike). Funkzioni i pajtueshmërisë së Bankës kërkon në mënyrë proaktive të përmirësojë menaxhimin e rrezikut të përputhshmërisë dhe kuadrin mbështetës të kontrollit. Banka operon në një treg ku ka një nivel të konsiderueshëm të aktivitetit të ndryshimeve rregullatore, prandaj, rreziku i pajtueshmërisë është një fushë kyçe e fokusit për menaxhmentin e lartë. Funkzioni i pajtueshmërisë monitoron këtë rrezik duke iu referuar metrikës përkatëse për Bankën, rishikimit të raporteve dhe vlerësimeve të incidentit, vlerësimeve të rrezikut dhe kontrollit që kanë të bëjnë me linjat e para dhe të dyta të funksioneve të mbrojtjes, rezultatet e vlerësimeve rregullatore, ndjekja e risive që vijnë nga pocesit e mbikqyrjes ligjore dhe rishikimi i rezultateve të auditimit të brendshëm dhe raporteve të auditimit të jashtëm. Përmirësimi i kontroleve kryhet në kohën e duhur.

**(h) Menaxhimi i kapitalit**

Objektivat kryesore të politikës së menaxhimit të kapitalit të Bankës janë të sigurojë që Banka të jetë në përputhje me kërkesat e imponuara nga jashtë për kapital dhe ruan vlerësime të forta krediti dhe raporte të shëndetshme kapitali për të mbështetur biznesin e saj dhe për të maksimizuar vlerën e aksionerëve. Banka menaxhon strukturën e saj të kapitalit dhe bën rregullime në të në përputhje me ndryshimet në kushtet ekonomike dhe karakteristikat e rrezikut të aktiviteve të saj. Për të ruajtur ose rregulluar strukturën e kapitalit, Banka mund të rregullojë shumën e pagesës së dividendit për aksionarët, t'u kthejë kapitalin aksionarëve ose të emetojë letra me vlerë të kapitalit. Megjithatë, tre vitet e fundit Banka e Shqipërisë i ka ndaluar bankat të shpërndajnë dividend.

## OTP BANK ALBANIA SH.A.

### Notes to the financial statements

(amounts in Lek'000, unless otherwise stated)

#### 41. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

##### (h) Menaxhimi i kapitalit (vazhdim)

###### *Kapitali Rregullator*

Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit të saj duke përdorur, ndër masat e tjera, rregullat dhe raportet e vendosura nga rregullatori shqiptar, Banka e Shqipërisë (“BSH”), e cila në fund përcakton kapitalin ligjor që kërkohet për të mbështetur biznesin e saj. Rregullorja “Për mjaftueshmërinë e kapitalit” është nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Ligji Bankar i Republikës së Shqipërisë”.

###### *Raporti i mjaftueshmërisë së Kapitalit*

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (“RMK”) është raporti i kapitalit rregullator ndaj totalit të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, i shprehur në përqindje. Raporti minimal i kërkuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është 12%.

###### *Ekspozimet e ponderuara sipas rrezikut (EPR)*

Aktivët e ponderuara me rrezik llogariten si një shumë e sa vijon:

- Ekspozimet e ponderuara me rrezik të aktiveve brenda dhe jashtë bilancit të cilat ponderohen sipas qasjes së standardizuar të rregullores së BSH-së për “Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”. Sipas kësaj metode të gjitha ekspozimet dhe ekspozimet e mundshme grupohen në kategori të caktuara ekspozimi dhe brenda secilës prej tyre në grupe më të vogla sipas rrezikut që lidhet me to.
- Kërkesa për kapital për të mbuluar rrezikun e tregut
- Kërkesa për kapital për të mbuluar rrezikun operacional, duke përdorur metodën e treguesit bazë

Shtesat makroprudenciale të kapitalit në vitin 2023 ishte në nivelin 2% (2022: 1.5%). SIST për bankat me rëndësi sistemike është 0.5%. Sipas rregullores së Bankës, raporti minimal i kërkuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është 12%. Banka është në përputhje me një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit më 31 dhjetor 2023 dhe 2022:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Kapitali i nivelit të parë	21,639,429	19,174,815
Instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë	774,945	-
<b>Kapitali rregullator</b>	<b>22,414,374</b>	<b>19,174,815</b>
<b>Aktivët e ponderuara me rrezik</b>	<b>114,642,330</b>	<b>118,009,451</b>
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	19.55%	16.25%
Raporti minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit të kërkuar	12.00%	12.00%

Deri më 31 dhjetor 2023, borxhi i varur është përfshirë në llogaritjen e kapitalit rregullator Nivelit të Dytë.

Banka i bëri një kërkesë zyrtare bankës qendrore për përfshirjen e borxhit të varur në kapitalin e nivelit II më 28 dhjetor 2023, që është para përfundimit të periudhës raportuese. Banka konsideroi se provat e kushteve të miratimit rregullator ekzistonin në fund të periudhës raportuese dhe ajo kishte bazë të fortë për të besuar se miratimi ishte praktikisht i sigurt. Miratimi u mor në 25 janar 2024, i cili, edhe pse pas periudhës raportuese, dha konfirmim të mëtejshëm se kushtet për përfshirjen ishin përmbushur që nga data e raportimit.

Në datën 31 dhjetor 2023, fitimi për periudhën 6 mujore që përfundon më 30 qershor 2023 në shumën prej 1.597.460 mijë lekësh është përfshirë në kapitalin e Nivelit të Parë pas rishikimit të audituesit të çertifikuar dhe me miratim nga rregullatori. Gjysma e dytë e fitimit të vitit aktual përfshihet si element i kapitalit të Nivelit të Parë pasi pasqyrat financiare janë çertifikuar dhe raportuar tek rregullatori dhe pasi çdo dividend i ndërmjetëm (i pjesshëm) i paguar gjatë vitit, taksat dhe detyrimet e tjera mbi fitimin janë zbritur. Pas përfshirjes së fitimit të vitit aktual, Drejtimi vlerëson raportin e përshtatshmërisë së kapitalit në nivelin 20.64% më 31 dhjetor 2023 (2022: 17.09%).